QENDRA E STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE
PËR ARBËRESHËT

FJALIM
I KËSHILLTARIT TË SHTETIT

ANGELO MASCI

Mbi origjinën, zakonet dhe gjendjen e tanishme të shqiptarëve të mbretërisë së Napolit

Përktheu: Dr. Edmond Çali

QSPA
Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët

Titulli i origjinalit:
Discorso del consigliere di stato Angelo Masci sull'origine,
i costumi e lo stato attuale degli albanesi del Regno di Napoli

Përktheu: Dr. Edmond Çali
Redaktore shkencore: Prof. dr. Klara Kodra
Redaktore letrare: Ervisa Paloka

Falenderojmë për kontributin e dhënë për përkthimin e pasazheve
nga latinishtja, Prof. as. Elda Molla dhe Prof. as. Leonard Xhemani
dhe nga spanjishtja, znj. Arlinda Grazhdani.

Përgatiti për botim: Dr. Silvana Nini dhe Dr. Dorina Arapi

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra
e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA)

ISBN 978-9928-4664-9-5

FJALIM
I KËSHILLTARIT TË SHTETIT
ANGELO MASCI

MBI ORIGJINËN, ZAKONET DHE GJENDJEN E TANISHME TË SHQIPTARËVE TË MBRETËRISË SË NAPOLIT

PËRMBAJTJA

Parathënie e botuesit 9

Dy fjalë për shqiptarët nga Gabrile Frega 11

Jeta e Angelo Masci-t 15

Hyrje 21

Kapitulli I 23
Mbi origjinën e shqiptarëve

Kapitulli II 41
Një vështrim mbi historinë e shqiptarëve

Kapitulli III 49
Zakonet e shqiptarëve

Kapitulli IV 63
Kolonitë e shqiptarëve në Mbretërinë e Napolit
Historia e vendosjes së tyre, numri i tyre dhe gjendja e tyre
Shkaqet e përparimit të ngadaltë që kanë bërë në kulturë

Kapitulli V 73
Rëndësia e mbrojtjes së kësaj popullsie dhe rëndësia e pranimit të një sasie tjetër shqiptarësh. - Mjetet e gjetura nga qeveria e kaluar për të përmirësuar gjendjen e saj

Përfundim 87

Pasthënie nga Klara Kodra 89

PARATHËNIE E BOTUESIT*

Ky fjalim u botua në Napoli në vitin 1807. Maltebrun-i i famshëm e përktheu në frëngjisht dhe e përdori shumë në veprën e tij të madhe. U mor dhe u botua i plotë në gazetat më të mira franceze. Tani, meqë mezi gjenden botimi i parë dhe botimi i dytë dhe, duke pasur shumë kërkesa, sidomos nga ana e shqiptarëve, mendova se ishte e udhës të bëja një botim tjetër. Meqë shqiptari Marko Boçari dhe trima të tjerë panë që atyre t'u ngrihen statuja nga e tërë Europa, lindi midis shqiptarëve gara fisnike që të nxjerrin në pah origjinën dhe madhështinë e këtij populli, që ka dhënë prova se i njeh më mirë se sa grekët e tjerë të mirat e një qenësie kombëtare. Ky shkak, së bashku me dëshirën për të nderuar kujtesën e xhaxhait tim, më nxiti që të bëj botimin e tretë.

[*Francesco Masci]

DY FJALË PËR SHQIPTARËT

Kombi shqiptar meriton vëmendjen e filologëve të Europës për çdo gjë që ka lidhje me të dhe, në qoftë se për një kohë të gjatë u la në harresë, tani duhet të marrë në histori atë vend që meriton të zërë. Në qoftë se letrat mund të pasurohen me zbulime të dobishme, historia mund të shtojë faqen e një populli të madh.

Të vërvitur në malet Akrokeraune si të mbijetuarit nga një anije e mbytur, kanë mbetur të mbyllur për shumë shekuj ndaj zbulimeve të shkencës. Cilët janë? Nga vijnë? - Ja çfarë historia nuk ka mundur kurrë të hetojë. Në mes të kombeve moderne, ai komb nuk ka asgjë të ngjashme me kombet e tjera. Me një vulë krejt të vetën për karakterin, zakonet, doket dhe krenar për një gjuhë të lashtë dhe të zanafillës, që nuk pati modele, por edhe që nuk qe nënë e ndonjë gjuhe tjetër, tingëllon si një kujtim i brishtë kohësh të humbura. Do të vijë ndoshta një ditë që ky komb do të mund të shfaqet me shkëlqim në historinë e botës, dhe të sjellë aty filizin e të vërtetave të lashta. Kushedi, nëse nuk është një nga ato mbeturinat e kataklizmave të natyrës, që kaluan si rrebeshe mbi tokë dhe i shtynë të lëna në harresë në një skaj të bregut? E ngjashme me këngët e tyre që ngrihen lart me zë të hollë dhe që dëgjohen shumë milje larg, të zbret në shpirt rrëfimi i ndodhive të tyre, dhe të rizgjon ide të një bote të re, e cila nuk mbahet më mend.

Dëgjova të thuhet njëherë që një udhëtar të kishte bërtitur në mes të shkretëtirave të Amerikës: "Sa kombe u zhdukën këtu si një tingull pa jehonë!" E po! Unë kam gjithmonë të njëjtën përshtypje në mes të këngëve, të zakoneve dhe të riteve të popullit shqiptar. Ai ka diçka të lartë, përrallore, të panjohur si të një populli parak, të shuar prej shumë shekujsh.

Por, në qoftë se origjina e këtij kombi jep gjithçka të pasigurt dhe të errët, historia e ngjarjeve të tij të luftës është e paanë si ajo e Spartës dhe e Romës. Ishte në kulmin e vet ende Greqia, kur shqiponja maqedonase e hodhi fluturimin dhe e mbuloi tokën me krahët e saj. Përmbysi Perandorinë Persiane dhe, pas shumë fitoresh, ky popull e shpërfillte mundësinë që të ndiqte synimet ambicioze të Aleksandrit: më vonë, me një guxim që nuk mund të rrëfehet, sfidoi krenarinë e fuqisë romake, ndërsa fushat e Epirit nxirrnin tym nën rrënojat e shtatëdhjetë qyteteve. Shqipëria, edhe pse e humbi luftën, nuk u nënshtrua; dhe vetëm ajo kishte mbetur e lirë nga popujt vasalë të romakëve; dhe kur hordhitë e turqve mbinë papritur nga shkretëtirat e Azisë, dhe kur gjysmëhëna u valëvit mbi kupolën e Shën Sofisë në Kostandinopojë duke kërcënuar Krishterimin, shpirti i madh i Gjergj Skënderbeut, me një grusht shqiptarësh, e la botën të habitur. Ky njeri i jashtëzakonshëm, një Aleksandër i dytë, në fushat e Farsalia-s, të mbuluara nga hiri romak, bëri fli prej tërbimit njëzet mijë myslimanë. Dy sulltanë zbritën në varr si hije të zemëruara përpara figurës së tij që qëndronte drejt. Napoloni i mbyllur në madhështinë e oqeanit, në vetminë e tij, e përmendte Skënderbeun midis njerëzve më të mëdhenj.

Dhe nuk mbaron këtu historia luftarake e këtij populli. Në prag të këtij shekulli u shfaq si vigan dhe e shpëtoi Greqinë në kthetrat e shqiponjës së Selleide-s. Bota pati për herë të dytë shfaqjen e një Leonidhe të dytë, arkivoli i shqiptarit Marko Boçari u qa nga të gjithë fisnikët e botës. Ishte bir i Shqipërisë ai pashai i madh, që u lartësua i tmerrshëm kundër të gjithëve. Ali Tepelena, mendja më e hapët në marifetet luftarake, njeriu tipik i despotizmit të Lindjes. Shkeli me këmbë pashallarë e vezirë dhe pastaj e sulmoi me të gjitha forcat e mbledhura bashkë Portën, dhe duke vdekur thirri: unë ndeza pishtarët në funeralin e Perandorisë Otomane. Dhe shqiptar është Mehmet Aliu: ky gjeni, i dalë nga hiçi, u hakërrye se do të ringjallte forcën e kalifëve, nëse forcat e Veriut të Evropës të bashkuara në një koalicion të mos i kishin ndaluar fluturimet e tij mbi fushat e Sirisë [shënim i përkthyesit: në tekst 'Soria'] dhe përpara dyerve të kërcënuara të Kostandinopojës. Bajroni, princi i poetëve modernë, u shfaq në ato brigje dhe lira e tij dërgoi një dridhmë luftëtare, që u duk se rizgjoi karakterin e vjetër të shqiptarëve:

"Të rreptë bijtë e shqipes! Armiku ua pa kurrizin ndonjëherë? Kush si ata e duron mundimin e luftës? *Tamburgi! Tamburgi!* është thirrja e luftës, kur e dëgjojnë gjëmimin e saj zbresin si përrenj, fluturojnë si shqiponjat, gjëmojnë si rrufetë."

Kjo vazhdë e pandërprerë ngjarjesh të mëdha dhe njerëzish të mëdhenj është një garanci e sigurt e një populli, sepse një komb ia beson fatin e vet forcës së bëmave, dhe jo sofizmave të Gorgia-s. Në qoftë se Shqipëria, ashtu si Sparta, nuk pati deri tani një kulturë në fushën e letrave, kjo gjë është për shkak të prepotencës së ngjarjeve të jashtme dhe nuk është prej karakterit përbërës të atyre njerëzve. Poezia popullore, nga e cila ruhen ende këngë, e ka zanafillën nga një prejardhje e lashtë, dhe dashuria e pafund e kombit për ta ruajtur dëshmon një natyrë poetike në shkallë të lartë.

Sepse, po të duam të shkojmë më tej, kush mund të mohojë që Aristoteli nuk lindi dhe nuk jetoi në tokën shqiptare? Që, në qoftë se Homeri nuk kishte atdhe tjetër veçse botës, kush do të mohojë provat që e mbështesin atë?

O, bij të Epirit, dëgjoméni: në buzët tuaja jehon një gjuhë e lashtë sa bota; ju, duket sikur jeni hedhur në mes të popujve të botës si këngët e Homerit; dhe origjina e këtyre këngëve ka humbur; por në fytyrat tuaja ndodhen akoma gjurmët e një madhështie të së kaluarës dhe kombet do të lexojnë aty gjithmonë të ngulitur shpirtin e Akilit, të Aleksandrit dhe të Skënderbeut!

Gabrile Frega

JETA E ANGELO MASCI-T

Ai duket sikur të ketë qenë mendimi i parë i *bugliaart*-ëve të Shqipërisë që në mbarim të shekullit XV mërguan në Itali, ai i themelimit të një atdheu që të shpëtonte kundër kohës edhe bijtë, edhe kujtesën e vet që po ua linin atyre. Nuk është se linin të shkruar nëpër libra ndonjë ligj, por, duke imituar Likurgun, ngulitnin statutet në zakonet dhe te disiplina që të vijonin në përjetësi. Ata në kishat, në altarët e të cilave më të fismit ngulën stemat e tyre, ndanë për çdo familje vendet dhe varret; dhe, si në atdheun e lashtë, edhe këtu u mbajt si i poshtëruar ai që do të kishte lidhur martesë me të huajt. Ata madje caktuan një muaj në pranverë, gjatë të cilit fshatrat e të mërguarve trashëgimtarë të ishin të hapur për të pritur *rusalles*-et e ndërsjella, ato kore të mëdha me maska, që përkujtonin vendin e lashtë dhe bëmat e mëdha që ishin kryer atje.

Por me çfarë besimi dhe me çfarë shprese deshën ata që atdheu i tyre të mos i humbiste bijtë e tij? Kush mund ta dijë? Nga veprat e tyre del se midis nesh është ende i gjallë entuziazmi për bëmat e mëdha; dhe akoma nuk u krijua një kult i plotë për arin dhe për pushtetin. Populli ynë, meqë është i mbyllur në fshatra të vogla, ruhet i virgjër; dhe, meqë klasat e ndryshme nuk janë shkëputur nga njëra-tjetra, të fundit marrin pjesë në kulturën e të parave, dhe edukimi i veçantë dhe privat bëhet publik dhe i përbashkët.

Familjet më të kamura i dërgojnë bijtë të tyre të nderuar në Kolegjin e Shën Adrianit[1], që është shenjtërorja, është tempulli që i pret në altarët e vet pasardhësit fisnikë të Epirit. Aty ata thithin kulturën greke dhe latine në atë mënyrë, saqë ajo bëhet kultura e tyre; dhe më pas, duke ardhur në gjirin e atdheut, ruajnë atë mënyrë të menduari, edhe kur jetojnë bashkë me njerëzit nga vegjëlia, dhe kështu praktikisht ua mësojnë edhe këtyre. Njëra nga këto familje është familja Masci në Shën Sofi.

Noè Masci, babai i katër fëmijëve, vdiq i ri, dhe la nën kujdesin e bashkëshortes së tij të virtytshme, frytet e njoma të dashurisë së tyre. Donna Vittoria Bugliari, në mënyrë që humbja e burrit të mos e vinte poshtë, gjeti me kalimin e kohës një shpërblim dashurie te fëmijët, të cilëve u kushtoi të gjithë zemrën e saj. Por fëmija i parë që po rritej në shkollat kombëtare (që ishin hapur atëherë në San Benedetto) pas pak la një zi tjetër në strehën prindërore. E mbetur atëherë vetëm me tri fëmijë, ajo nuk ua ndante sytë atyre, duke pasur frikë se mos i humbiste. Nuk ishin mosmarrëveshje, nuk ishin gara shtëpiake mësimet e para të Masci-t të vogël, por përkundrazi psherëtimat e dhembshura të një zemre të shkretë dhe të mbushur plot me zymtësi. Prandaj ai pati një shpirt të devotshëm dhe njerëzor, si ai i nënës.

Dhe janë me fat bijtë, në qoftë se mund të fillojnë edukimin letrar, pa e ndërprerë moralin, që marrin nga nënat. Asnjë mësues nuk do të mund të ketë zërin e dashur të nënave dhe as mund të digjet aq shumë nga dashuria për nxënësit e tij; megjithatë, pa dashuri dhe pa virtyte, nuk do të ketë shkollë të mirë në botë. Angelo Masci e pati të plotë këtë lumturi. Në fshatin e tij jetonte atëherë Don Stefano Pasquale Baffi, një specialist i letërsisë greke dhe i letërsisë latine, dhe i aftë që të fillonte një edukim të mirë letrar te të rinjtë. Duke ndjekur ecjen përpara në vite dhe në studime të nxënësit të tij, ai gjente mjete të reja për të zgjuar ndjenjat e bukura të zemrës, për të nxitur aftësitë e shkëlqyeshme të mendjes së tij. Si shtangu në vend Angelo Masci, kur atij iu hapën vëllimet e shenjta të lavdisë së lashtë? Sa u entuziazmua, kur u gjend midis të mëdhenjve të Athinës dhe të Romës? Të gjitha prirjet fisnike që iu zgjuan atëherë,

të gjithë filizat e së mirës u zhvilluan në zemrën e tij dhe lulëzuan pastaj në një mënyrë që, siç e kishte shpresuar ai me drithërimat e para rinore, më vonë u quajt nga të gjithë Aristidi i ditëve tona...

Filozofia, duke përgjithësuar parimet tona dhe duke i hapur një fushë më të gjerë arsyes, mbjell bazat themeltare të mënyrës sonë të të menduarit. Për të studiuar këtë shkencë, Angelo Masci shkoi në Napoli, ku bëri përparime të mahnitshme. Por për çfarë hyn në punë shkenca në qoftë se nuk vihet në shërbim të njerëzimit? Shkencëtari i mbyllur në kabinetin e tij, është si ata thesaret e mbuluara në zemër të tokës; prandaj në fushën e edukimit duhet pasur si qëllim dobia shoqërore, dhe drejt kësaj të shkojë vëmendja jonë.

Me zemrën plot me ndjenja për drejtësinë, Angelo Masci deshi të bëhej gjykatës dhe të hynte në tempullin e shenjtë të drejtësisë. Unë mendoj se juristi është një ligjvënës i dytë, dhe akoma më i dobishëm, kur priret të zbatojë dëshirën fisnike të atij që ka përcaktuar me ligj normën e të jetuarit shoqëror.

Nevojat e popujve dhe zhvillimi, ecja përpara e shpirtit njerëzor, dhanë një doktrinë që është shpaguese e të drejtave të kujtdo, dhe dorëzanë e paqes së përbashkët. Çdo popull ka formuar legjislacionin e vet, por të gjithë popujt përdorën dhe morën doktrinën e popullit nga rrënojat e të cilit u lartësuan popujt e rinj të Europës. Legjislacioni romak u bë si një fatrrëfyes i hapët, nga i cili morën përgjigjet legjislacionet e tjera; dhe përpara tribunës zyrtare të gjykatës romake u vendosën paditë e të gjitha kohëve. Kush hyn pa frikën se mos humbet në oqeanin e gjerë të legjislacionit romak? Dhe, megjithatë, kjo gjë qe pak për zgjuarsinë durimtare të Masci-t, që për më tepër nxori nga varri vullnetet e shpërndara të Mesjetës dhe punoi për ta riçuar gjithçka tek e drejta e parë universale e njeriut, krijesë hyjnore. Ndoshta, zëri i drejtësisë që i fliste atij çdo ditë, dha një ndihmesë të madhe për vendosmërinë e paanshme dhe të padiskutueshme, të shpalosur nga ai më tej në të gjitha çështjet. Ai ishte si dielli, që, si qytetar i gjithë botës e përhap dritën e tij edhe për më të largëtit. Nga të gjitha anët rendnin që të mbroheshin prej tij, dhe besonin që ishin me fat, nëse viheshin nën hijen e një njeriu të tillë. I nderuar nga borgjezia, kishte lidhje

miqësie me parinë e kohës së tij. Do të thosha të gjithë miqtë e Angelo Masci-t, po të ishte e nevojshme që të mbështetej nga mendimi i të tjerëve, ishin gati ta mbështesnin; por ai la një famë që e mban vetë veten e vet.

Kur u rivendos rendi publik pas vitit 1799, Masci filloi sërish ushtrimin e profesionit të tij dhe pas pak kohe u vu në këmbët e tij çmimi më i bukur që kurrë ndonjëherë t'i jetë dhënë një shpirti të mirë dhe të ditur, dhe që e ka merituar të tërin. Ishte koha që Europa me një përpjekje të padëgjuar po përmbyste feudalizmin.

Komisioni Feudal i Napolit vepronte energjikisht dhe, i frymëzuar nga parime të mëdha, nuk e lejoi që drejtësia t'i nënshtrohej forcës. Por, që t'ia arrinte qëllimit, kishte nevojë për njerëz që të mos e tradhtonin në zbatimin e urdhrave të tij. Angelo Masci u zgjodh si anëtar i Komisionit në Ndarjen e Pronës Shtetërore të Provincave të Kalabrisë së Mesme dhe të Capitanata-s.

Të gjithë mund ta marrin me mend se sa e vështirë ishte që t'ua hiqje feudalëve prenë që kishin në dorë. Kush në një mënyrë, kush në një tjetër, të gjithë kërkonin t'u bënin bisht vendimeve të Komisionit...

Ai qe modeli më i lartë i paanësisë dhe i ndershmërisë në ato kohë. Dhe, që kur ishte gjallë, e dëgjoi me veshët e vet që e krahasonin me Sokratin e lashtë. Edhe tani popullsia e Catanzaro-s dhe e Basilicata-s e nderojnë kujtimin e tij të pavdekshëm.

Pasi përmbushi këtë detyrë të rëndësishme, erdhi për të vendosur Gjykatën Civile në Cosenza; nga ku kaloi si prokuror i përgjithshëm i Gjyqit të Apelit në Catanzaro; por, meqë nuk ishte e përshtatshme për të klima e këtij qyteti, deshi të kthehej me detyrën e zëvendësprokurorit të përgjithshëm të Gjyqit të Apelit në Napoli. Pas pak vitesh u zgjodh këshilltar shteti; nga ku kaloi pastaj që të gëzonte në paqe dhe larg nga çështjet pjesën tjetër të jetës së tij të nderuar.

Tani që ai nuk jeton më, dhe ato kohë po harrohen, emri i tij mbetet gjithmonë i lidhur me dy vepra të ndërgjegjshme dhe plot me pikëpamje të drejta dhe që kanë një meritë e rëndësi që zgjasin në kohë.

L'esame politico legale de' diritti e delle prerogative de' baroni nel regno di Napoli ("Shqyrtimi politik legal i të drejtave dhe i privilegjeve të baronëve në Mbretërinë e Napolit") dhe *Il discorso sull'origine, costumi e stato attuale della nazione albanese* ("Fjalimi mbi origjinën, zakonet dhe gjendjen e tanishme të kombit shqiptar"), japin një dëshmi të dijeve të tij të gjera dhe të pikëpamjeve të tij të thella politike dhe ekonomike.

Prej këtyre dy veprave, e fundit ka marrë rëndësi në mënyrë të veçantë, sepse, duke reaguar kundër prirjeve zgjidhëse të ditës, midis nesh është bërë e madhe dëshira e zjarrtë për të ruajtur ritet, mendimet dhe gjuhën që na lanë etërit tanë bashkë me gjakun; duke vazhduar vullnetin e tyre, që është për të gjithë ne një ligj nderi i shenjtë.

Angelo Marchianò

HYRJE

Është një kureshtje e kotë të hetosh për origjinën e kombeve? Është një erudicion i panevojshëm të dish karakterin dhe zakonet e popujve të ndryshëm të botës? Të dyshosh për dobishmërinë e detyrave të tilla, është si të ecësh me hapa të mëdhenj drejt barbarisë.

Në të vërtetë studimi më i mirë që mund të bëhet për njeriun, është që të studiohen zakonet e tij. Por, nëse këto janë karakteristike të vetat, ose të huaja, është një mendim që mund ta japë ai që arsyeton me mend: ajo që është e huaj nuk e bën karakterin e njeriut, meqë njeriu është kafsha më e lidhur me imitimin; por ajo që është e vetja bën që të formohet ideja e vërtetë e zhvillimit e aftësive të tij.

Shqyrtimi i zakoneve të bën të njohësh njeriun. Ngjashmëria midis barbarëve, ndryshimi nga njëri-tjetri i popujve të kulturuar, përparimet e ngadalta të dijes njerëzore, ndikimi i karakterit mbi moralin dhe mbi politikën, kushtet lehtësuese ose pengesa të zakoneve për kulturën dhe për mirëqenien e një kombi, janë çështjet më të rëndësishme që mund të ketë si pikësynim filozofi me mend në kokë.

Një komb sa i famshëm po aq pak i njohur, një komb që për shekuj e shekuj nuk e ka tjetërsuar as karakterin e vet, as zakonet e veta; një komb që gjithmonë në mes të popujve të kulturuar i ka mbajtur, dhe që edhe tani i mban zakonet barbare, e meriton sigurisht vëmendjen e njeriut të letrave. Megjithatë për këtë komb nuk është shkruar asgjë në mënyrë të saktë; dhe, nëse dikush pothuajse kalimthi ka folur për të, e ka penguar me mjaft gabime të vërtetën.

Ky është kombi shqiptar, i cili, jo vetëm që zë një territor shumë

të madh, ku është rrënjës, duke filluar që nga Shkodra e deri në Artë, por që ka të shpërndara në More, në Sicili dhe nëpër Itali ngulime të pafundme. Zakonet e këtyre njerëzve me siguri duhet t'i interesojnë kujtdo që studion zhvillimin e popujve dhe zhvillimin e njeriut; por interesi më i madh duhet të tregohet nga mbretërit tanë të vegjël, jo vetëm sepse të shpërndarë nëpër provincat tona jetojnë mijëra shqiptarë, të cilët sot përbëjnë një pjesë jo të vogël të pasurisë kombëtare, por edhe sepse afërsia me Maqedoninë dhe me Epirin, mund të jetë një mjet për të shtuar popullsinë e paktë në numër në mbretëri, kur kjo gjë drejtohet mirë; kështu mund të hapet edhe një burim i pashtershëm pasurish me anë të tregtisë.

Kapitulli i parë

MBI ORIGJINËN E SHQIPTARËVE

Rajoni që sot quhet Shqipëri, shtrihet për gjithë atë hapësirë që në lashtësi quhej *Illyria Graeca,* ose dhe *Macedonia*, duke filluar nga lumi Drilo [Drini] e deri në malet Akrokeraune. Epiri, që megjithatë mban emrin e mëparshëm, fillon në Akrokeraune dhe vazhdon deri në Artë, që më parë quhej *Ambracia*. Tani nëpër të gjithë këtë shtrirje tokash, e gjatë afro 700 milje dhe e gjerë (duke marrë gjerësinë mesatare) rreth 270 milje, ka vetëm shqiptarë, të cilët ndryshojnë nga grekët, nga sllavët dhe nga turqit për nga gjuha dhe për nga zakonet.

Ky ndryshim ka ngjallur te shkrimtarët idenë se *Shqiptarët* nuk janë rrënjës në Greqi, por që ta kenë zanafillën e tyre nga Albania e lashtë aziatike e vendosur midis Detit të Zi dhe Detit Kaspik. Enea Silvio[2], Mangini[3], Antonio Bonfinio[4], Tommaso Cornelio[5] dhe

[2] *Descript. Europ. Kap. 15 – Credimus hoc genus hominum ex Albania quondam venisse, quae vicina Colchidi in Asiatica Scytia memoratur, ut saepe Barbarorum inundatio Nationum Graeciae, atque Italiae provincias occupavit. (Besojmë se ky fis ka ardhur dikur nga Shqipëria, e cila përmendet se është afër Klokidit në Scitia Aziatike, pasi shpesh dyndja e Barbarëve pushtoi provincat e Kombeve të Greqisë dhe të Italisë.)*

[3] *Moderne Tavole di Geografia aggiunte a Tolomeo Cap. dell 'Epiro – Duan që ky Epir me pjesën e Maqedonisë që kemi përmendur më parë, tani të quhet Albania nga albanët, popuj të Azisë, të cilët u vendosën këtu meqë u dëbuan nga tartarët.*

[4] *Rer. Ugnar. decad.1. lib.1. - Ab his (Albanis Asiae.) Albani quoque orti sunt, quorum pars hoc tempore in Peloponneso, pars in Macedonia juxta Dyrrachium plane consedit. (Rer. Ugnar.decad.1. lib.1 –Albanët kanë lindur gjithashtu nga këta (Albanët e Azisë), një pjesë e të cilëve u vendos në Peloponez, një pjesë në Maqedoni pranë Dyrrahut.)*

[5] *Dictionar. Art. Albanopolis.*

Fidelfo[6] janë pikërisht të këtij mendimi. Martinier-i[7], edhe pse jo nga albanët aziatikë, por nga Albanopoli grek e merr emërtimin e shqiptarëve, prapë edhe ai gjen te ta një prejardhje skite. Tani, nëse këta autorë kanë ndër mend të flasin për kohët e largëta, ndoshta gjejnë disa autoritete te të cilat të mbështesin mendimin e tyre[8]: edhe pse autoritete të tjera thonë se albanët aziatikë e kanë prejardhjen nga tesalianët të çuar aty nga Jasoni[9]. Por për çfarë na hyn në punë që të kërkojmë gjurmët e një lashtësie kaq të largët dhe të të dhënave kaq të largëta nga kujtesa e njerëzve? Duke llogaritur nga periudha e artë e Greqisë e deri në rënien e Perandorisë së Kostandinopojës, asnjë koloni e albanëve aziatikë nuk e ka populluar Epirin dhe as Maqedoninë. Historia nuk do ta kishte lënë pa e përmendur dhe pa e shpjeguar një të dhënë kaq të rëndësishme edhe që nga kohët më barbare, meqë këto rajone janë banuar gjithmonë nga rrënjës të ndritur dhe luftarakë.

Albanët aziatikë banonin afër Kolkidës dhe maleve kaukaziane[10], ku sot gjendet Gjeorgjia. Gjuha e kolkidasve, sipas dëshmisë së

---

[6] *Epist. Ad Ludovic. Foscarin. et ad Christophor. Maurum. - Albani, qui a nostris Albanenses vulgo, a Graecis Albanitae nominantur, populi origine Asiatici, vergentes tamen ad Septentrionem, qui Caucaso Monte a Colchis divisi, ad Indos prope usque praetenderent. Unde jam quidem magnis viribus surgentes, intra sinum Adriaticum cosenderunt. (Letër Ludovik. Foskarin. dhe Kristofor Maurit. – Albanët, të cilët nga populli ynë quhen Albanenses, nga grekët quhen Albanitë me origjinë të popullit aziatik të drejtuar drejt Veriut, të ndarë nga Mali i Kaukazit, shtriheshin deri afër indianëve. Prej andej, pa dyshim të ngritur me fuqi të mëdha zbritën në gjirin Adriatik.)*

[7] *Dictionar. art.* Albanopolis.

[8] Plinio *lib.* 4 *Kap.* 22 *Hist.* Duke folur për Ulqinin, thotë: *Olchinium, quod antea Colchinium dictum, a Colchis conditum. (Ulqini, që më parë njihej me emrin Colchinium, është themeluar nga banorët e Kolkidës.)*

[9] Plin. *Hist. lib.* 6. *Kap.* 13. *Dein per oram* Albani, *ut fuerunt ab Jasone orti. (Më vonë, Albanët përmes bregut, siç lindën nga Jasoni.)*
Tacit. *Annal. lib. 6. 34. Nam Hiberi, Albanique saltuosos locos incolentes, duritiae, patientiaeque magis insuevere. Feruntque se Thessalis ortos, qua tempesate Jason post avectam Medeam, genitosque ex ea liberos, inanemmox Regiam Osetae, vacuosque Colchos repetivit. (Në fakt iberikët dhe albanët banues në vende me pyje, ishin mësuar me jetë të vështirë e të mundimshme. Thonë se kanë lindur nga thesalët, në kohën kur Jasoni, pasi kishte rrëmbyer Medean, dhe fëmijët e lindur prej saj, më vonë Regian e Osetes, dhe sulmoi vazhdimisht kolkët.)*

[10] *Strab. lib. XI. Kap.*

Herodotit[11] ishte e ngjashme me atë të egjiptianëve dhe kjo gjuhë, për sa u përket fjalëve që na kanë mbetur, nuk ka të bëjë fare me gjuhën shqipe. Por çfarëdo ngjashmërie që të ketë me gjuhën e lashtë kolkidase, gjeorgjishtja e sotme nuk ka kurrfarë ngjashmërie me shqipen, por është tërësisht ndryshe për sa u përket fjalëve dhe mënyrës së shprehjes[12].

[11] *Lib. 2. Kap.*

[12] Leibnitz *Epist. ad Andream Acoluthum* (Leibnitz *Letër Andreas Akoluto) 10.Octb.1695. Collect.bleu. 6, p. 2, f. 138* na jep shumë fjalë të asaj gjuhe; nga këto fjalë unë do të citoj disa për të treguar dallimin nga shqipja.

italisht	**gjeorgjisht**	**arbërisht**	përkthimi i italishtes [Shtoj në shtyllën e katërt përkthimin në shqipen e sotme të fjalëve në italishte. Shënim i përkthyesit]
Uomo	*aniri*	*gnerii*	*njeri*
bocca	*bache*	*grich*	*gojë*
Sedia	*Sella*	*thron*	*karrige*
sera	*seri*	*mbrâmma*	*mbrëmje*
Orto	*bostani*	*copset*	*kopsht*
bagno	*abano*	*rons*	*banjë*
bestemmiare	*agmozenebeti*	*malcuar*	*blasfemoj, nëm, mallkoj*
Cavaliere	*asnauri*	*caagliuar*	*kalorës*
figlia	*assuli*	*biglia*	*bijë*
notte	*agama*	*nat*	*natë*
rana	*bakak*	*bretkos*	*bretkosë*
gatta	*bi*	*macce*	*mace*
bove	*gili*	*cau*	*ka*
lupo	*chuli*	*ulc*	*ujk*
spada	*ghrmelli*	*cord*	*shpatë, pallë*
tempo	*dros*	*mot*	*kohë*
spina	*echati*	*ghiâmb*	*gjemb*
stella	*varskulaui*	*iil*	*yll*
pomo	*vaskli*	*pemm*	*mollë, mollëz (e një bastuni); pomo d'Adamo: fikth, arrë e fytit*
fuoco	*zezili*	*zìarm*	*zjarr*
capo	*thaui*	*crìe*	*kokë, krye*
gallina	*katami*	*puugl*	*pulë*
vedere	*kedan*	*ruagn*	*shoh*
asino	*kizchi*	*gomar*	*gomar*
barba	*kueri*	*miechr*	*mjekër*
cane	*lekui*	*chien*	*qen*
padre	*mama*	*att*	*baba, atë*
sale	*marili*	*crip*	*kripë*

Më shumë: Albanët aziatikë ishin skitë, që quheshin edhe masagetë[13]; dhe këta janë pikërisht ata nga të cilët e kanë prejardhjen turqit[14]. Por që turqit janë një komb ndryshe në gjithçka nga kombi

lana	*matkeli*	*lese*	*lesh*
terra	*miza*	*dee*	*tokë, dhe*
serpente	*mkazi*	*ghiarpr*	*gjarpër*
Monte	*mta*	*rakk*	*mal*
selva	*drago*	*mààne*	*pyll*
Sole	*neze*	*diel*	*diell*
luce	*nathabi*	*drit*	*dritë*
sudore	*opti*	*diers*	*djersë*
guerra	*omi*	*gliuft*	*luftë*
cenere	*peopli*	*ghii*	*hi*
sonno	*pirculi*	*ghiumm*	*gjumë*
letto	*popne*	*sctrat*	*shtrat*
pane	*puri*	*buc*	*bukë*
latte	*rze*	*chiumsct*	*qumësht*
ferro	*rhicna*	*ghecur*	*hekur*
nome	*safeli*	*âmâr*	*emër*
casa	*sachieri*	*spii*	*shtëpi*
legno	*sese*	*druu*	*dru*
caldo	*sizche*	*vapp*	*vapë, ngrohtësi, nxehtësi*
sangue	*sischi*	*ghiach*	*gjak*
acqua	*skalè*	*ughi*	*ujë*
aceto	*smali*	*uthul*	*uthull*
anima	*sicli*	*spiirt*	*shpirt*
capra	*tka*	*dii*	*dhi*
neve	*touli*	*bora*	*borë*
Dio	*Ghmerti*	*Peerndii*	*Perëndi, Zot*
Madre	*sciobali*	*âmm*	*nënë*
verme	*cià*	*crimb*	*krimb*
ora	*zami*	*gheer*	*tani*
Cielo	*za*	*chiel*	*qiell*
mare	*zea*	*deet*	*det*
porta	*chari*	*deer*	*derë*
osso	*zuali*	*asct*	*kockë, asht, eshtër*
grano	*chirtili*	*gruur*	*grurë*

[13] Zonera duke folur për kohët e Adrianit *annal. bleu*. 1. *lib. VI,* nga fundi, shpjegohet kështu: *apud Albanos (sunt autem massagetae secundum Dionem) - te Albanët (janë masagetët /popull i Skitisë/ afër Dionës.)*

[14] Leibnitz Brevis designatio meditationum de originibus Gentium: *Collect. bleu. 4. pjesa. 2, f. 190. - Turcasex Regionibus venisse, quas qui nunc habitant* Usbecchii *vocantur, id est ex Massagetis vel scytis Persiae vicinis, satis apparet per ipsam gentis utriusque linguam. Cognatam esse Turcicae Tartaricam Praecopensem constat, et* Calmuccos *etiam (quod recens nomen credo, et a*

shqiptar, kjo nuk është një gjë që nuk dihet. Në po të njëjtat rajone nga ku kanë dalë turqit, flitet një gjuhë ndryshe nga shqipja; uzbekët, kalmukët dhe mongolët kanë një gjuhë të tyren[15].

Pastaj skitët, që lashtërisht quheshin *Sarmati* ose *Sauromati* janë ata që më vonë u quajtën *slavi*, ose *schiavoni*, emër nën të cilin përfshihen rusët, polakët, bohemianët, moravët, bullgarët, dalmatët e sotëm, rashianët, serbët, kroatët, sikulët[16], të cilët janë shumë të ndryshëm nga shqiptarët.

Janë skitë edhe gotët edhe hunët; por gjuha e gotëve ishte po gjuha e lashtë gjermane, dhe ajo e hunëve nuk mund të ishte një gjuhë tjetër, përveçse gjuha sllave[17].

Russis inditum), imo et Mogallos (quae vetus appellatio) serm one ad Turcas accedere proditur. Ipsi illi Orientaliores Tartari, Sinis imperantes, multa habent cognata Turcis vocabula, ex quibus nonnulla mihi R.P. Bouvetus suppeditavit. Ex Turcorum genere et Comanos *fuisse, qui tunc cum primum Tartari ingruerint, inter Taniam, et Daniubium sedes habebant, certis indiciis comperi. Eorum reliquiae in Hungaria supersunt (quo Tartarorummetu confugerant), sed lingua ni fallor amissa. (Leibnitz një rrëfim i shkurtër mbi origjinën e fiseve: Collect. bleu. 4. pjesa. 2, f. 190. - Kanë ardhur nga krahinat Turcasex, në të cilat tani banojnë uzbekët, ... nga masagetët si dhe skitët fqinjë të Persisë, duket nëpërmjet vetë fisit dhe gjuhës së secilit. Dihet se Tartarika Prekopense ka lidhje të afërta me Turqinë, dhe Klamukos (besoj tani vonë ka këtë emër, vënë nga rusët), në fund dhe mogalët (emri i vjetër) mendohet se i janë afruar turqve. Vetë tartarët e Lindjes, që komandonin në Sinis, kanë fjalë të ngjashme me turqit, disa nga të cilat R. P. Bouvet m'i tha me shumicë. Zbulova nga disa të dhëna se nga fisi i turqve qenë dhe komanët, të cilët kur i mësynë në fillim tartarët, kishin banimet ndërmjet Tanias dhe Danubit. Reliket e tyre janë në Hungari (prej andej shkuan në Tartarorumet), por gjuha ka humbur, nëse nuk gabohem.)*

[15] Shih pjesën e Leibnitz-it që kemi cituar më sipër. Dhe le të shtojmë që në të vërtetë, uzbekët flasin gjuhën persiane; dhe gjuha kalmuke dhe gjuha mongole janë pak a shumë e njëjta gjuhë: *Shih letrën e N. Witsenio-s drejtuar Leibnitz-it 16 tetor 1697. Collect. bleu. 6, p. 2, faqe 119. Pater noster – Ati ynë* në gjuhën mongole është krejt ndryshe nga shqipja, *ib. faqe* 204.

[16] Leibnitz *Brevis disegnatio etc. Collect. bleu. 4. pjesa. 2, faqe 191.*

[17] Leibnitz *loc. cit. - Ex* Prisci *Rhetoris legatione constat, duas tantum linguas in Aula Attilae usitatas fuisse, Goticam, et Hunnicam. Gothicam esse germanicam manifestum est, et vel Regum nomina demonstrationi sufficiunt. Hunnica autem, nisi ipsa fuisset Sarmatica, debuisset etiam tertia illic usurpari, cum Attila inter medias gentes Slavonicas tunc versaretur. Addo quod* Coni *vel Chuni vocabulo equum sarmatis significari constat, ut proinde Hunnorum nomine nil nisi equites significarentur. (Nga ambasadorët e rektorit Prisk thuhet se përdoreshin vetëm dy gjuhë në Aulën Attila, ajo gotike dhe hunike. Tregohej se gotikja ishte gjermanike, dhe emrat e mbretërve mjaftonin për provë. Gjuha*

Përveç kësaj, në qoftë se shqiptarët kanë ardhur nga Skythia, na vjen më për mbarë që të supozojmë që maqedonasit e lashtë dhe epirotasit të jenë shuar si popuj. Por si shpjegohet atëherë që, një fakt kaq për t'u shënuar, historia nuk e përmend fare? Autorët bizantinë flasin shpesh për bastisjet e skitëve nëpër provincat e perandorisë, por kurrë nuk përmendin faktin që ata të kenë vendosur ngulimet e tyre në Maqedoni ose në Epir.

Në të vërtetë duket një absurditet të shkulësh një komb të tërë të përbërë nga miliona frymë; dhe mungesa e konsekuencës rritet më tepër, në qoftë se mendojmë thellë dhe se kemi parasysh se ato vende tani janë shumë të populluara, dhe të gjitha të populluara nga shqiptarë. Një lukuni ardhacakësh, të cilët nuk dihet nga erdhën dhe kur erdhën, paska mundur të na japë një popullsi kaq të madhe në numër? Vandalët, gotët, longobardët etj., që ishin kombe të tëra, dhe për të cilat autorët flasin shumë, nuk kanë mundur të shuajnë të gjithë rrënjësit e Italisë, me gjithë përpjekjet e tyre; nuk kanë mundur të imponojnë përdorimin e gjuhës së tyre, as edhe zakonet e tyre; dhe, së fundmi, nuk kanë mundur të popullojnë një rajon të tërë, pasi ia kishin shuar banorët e lashtë: dhe, megjithatë, e gjithë kjo gjë mendohet si një gjë e lehtë për shqiptarët, kur dikush do që t'i zërë besë mendimit se këta paskan ardhur nga Skythia.

Por këtu është e nevojshme të shpjegojmë disa kalime të historisë bizantine, të cilat, të përshtatura keq, do të mund të ngatërronin rastësisht aq sa u tha deri tani. Giovanni Comeniata, i cili shkroi rreth vitit 900 të erës sonë, thotë kështu: "fushat e Tesalisë kanë brenda rrethimit të tyre shumë toka, prej të cilave disa i përkasin qytetit, dhe i paguajnë qytetit taksat duke u quajtur *druguditi*

Hunike nga ana jetër, nëse nuk ishte Sarmatike, duhet të konsiderohej atë kohë si e tretë kur Attila dyndej në atë kohë mes fiseve sllave. Shtoj atë që thuhet se me fjalën koni apo chuni duan të thonë kalin dhe prej andej nën emrin e hunëve nënkuptonin kalorësit.) Ky mendim përputhet më së miri me historinë, ndërsa, ashtu siç na del nga Ammiano Marcellino *lib.* 31. *në fillim*, hunët nga deti Azov shtriheshin deri në Oqeanin e Veriut, prandaj përfshinte sarmatë dhe masagetët. Dhe, për këtë arsye, Kedrinosi [Kedrenosi] në përmbledhjen e historisë së tij, *an. 6551. f. 767. Paris,* thotë se turqit që banuan në malet e Kaukazit ishin të racës hune.

dhe *lagudati*; disa toka të tjera janë haraçpaguese ndaj skitëve fqinjë, të cilët i kanë ngulimet e tyre jo shumë larg"[18]. Tani, kur flitet për këta skitë, me siguri është fjala për sllavët, të cilët pas vërshimeve të tyre me dhunë ishin vendosur afër Bosnjës, Serbisë dhe lumit Strymon [Struma], të gjitha vende këto që kufizohen me Maqedoninë. Madje për skitët e vendosur në malet Strymone flet shprehimisht Costantino Porfirogenita si më poshtë[19]: "Provinca e Strymonit është e lidhur me atë të Maqedonisë, por nuk gjendet kurrë e përmendur si provincë, meqë gjithmonë është konsideruar si një përkatësi e malit *Claustro*. Dhe skitët e përdorin si kullotë në vend të maqedonasve, që kur Giustiniano Rinotmeto, i quajtur Justiniani II Hundëpreri, vendosi aty ngulimet e tyre në malet e Strymonit dhe në ura druri". Duket sheshit, pra, që, sado që skitët, ose sllavët t'i ishin afruar shumë Maqedonisë, ata kurrë nuk i kanë vendosur ngulimet e tyre brenda saj, përndryshe Comeniati nuk do t'i kishte quajtur fqinjë dhe autokratë, por si përbërës të vetë vendit; dhe Porfirogeneti, meqë pati kujdes që të vinte në dukje e të jepte të gjithë të huajt për të cilët kishte dijeni se ishin futur në provincat e perandorisë, kështu nuk do të kishte munguar së përmenduri një popull barbarësh shumë të madh në numër, i cili na paskësh pushtuar rajonet më të bukura të Greqisë, pra, Maqedoninë dhe Epirin.

Po përse duhet të shkojmë e të kërkojmë midis aziatikëve dhe skitëve prejardhjen e shqiptarëve maqedonas, në kohën që kjo gjendet te vetë Greqia? Dhe jo në prova të kërkuara me zor; por historia jep për të gjithë këtë një dëshmi shumë të qartë. Autorët grekë, duke i konsideruar shqiptarët për ata që ishin në të vërtetë, pra rrënjës në Maqedoni dhe në Epir, nuk kanë ngritur kurrë një çështje për prejardhjen e tyre. Ai rajon, që sot quhet *Albania,* që lashtërisht e kishte emrin *Illirica Greca*; dhe grekët i gjykonin albanët të racës ilirike; dhe kjo pikëpamje mbizotëroi në çdo kohë deri te Kalkokondili, që shkroi pas rënies së Perandorisë së

[18] *De excid. Thessalonic. p. 3. edit. 22 Paris.*
[19] *Lib. 2. them. 3.*

Kostandinopojës. Vetëm se ky, ndoshta duke mos e ditur se banorët e sotëm të rajonit përgjatë Adriatikut që quhen në gjuhën popullore *Illirici* nuk janë ilirët e lashtë, por sllavë të vendosur atje në kohët e vona, duket se e hedh poshtë pikëpamjen e përmendur që grekët vazhdimisht e kishin bërë të vetën. Prapëseprapë vetë Kalkokondili për atë çka prek këtë pikëpamje duket se bie në kundërshtim me veten e vet; por, cilatdo qofshin dyshimet e tij, megjithatë është i një mendjeje, që as nga Azia, as nga Skythia duhet thënë se e kanë origjinën Albanët[20].

Pastaj që në të vërtetë Ilirët e sotëm nuk janë ilirët e lashtë, nuk ka asnjeri që të mos e dijë këtë gjë[21].

---

[20] Thotë kështu: *Pra duket se nuk është e vërtetë pikëpamja e atyre që besojnë se janë ilirë ata që ne quajmë* albanë. *Unë në të vërtetë nuk e pranoj këtë mendim që i bën albanët të racës ilire. Që pastaj albanët duke dalë nga Epidamni të jenë shpërndarë nëpër zonën bregdetare të Europës drejt lindjes dhe që të kenë vënë nën zgjedhën e tyre Tesalinë, Etolinë, Akarnaninë dhe një pjesë të madhe të Maqedonisë, edhe unë e kam mësuar i bindur nga disa hamendje dhe sepse kam mësuar shumë gjëra mbi këtë tezë. Por nuk e di se me sa themel mund të pohoj se nga Japigia të kenë kaluar në Epidamn, siç mendojnë disa, dhe prej këtu në atë krahinë që më së fundi kanë pushtuar, ose duke qenë fqinjë me ilirët banorë të Epidamnit, duke u afruar pak e nga pak ta kenë pushtuar krahinën e Epidamnit drejt Lindjes, Chalcond. De Reb.Turc. Lib. 1.*

[21] Leibnitz-i në disertacionin e sipërcituar *Brevis designatio etc.*, shprehet me këto fjalë: *Illiri Veteres, et Paeones, credo, olim Celtae, idest Germani, vel Semigermani erant. Slavonica vero lingua nullo jure Illyrica appellatur, etsi hodie slavi et Illiricum, et omnia loca vicina teneant, nam serius immigrarunt. (Ilirët e hershëm dhe Peonët, besoj, dikur ishin keltë, gjermanë, ose gjysmëgjermanë. Në fakt në gjuhën sllave në asnjë ligj nuk quhet Iliri, megjithatë sot sllavët zotërojnë të gjitha vendet fqinje dhe Ilirinë, në fakt imigruan më vonë.)*

Dhe në një letër drejtuar Gio. Ghamberlayno-s vetë Leibnitz-i thotë kështu: Male hoc posterius (scilicet alphabetum glagolicum) nonnulli authori S. Hieronymo gente Illyrio tribuent, falsa persuasione linguam veterem Illyricam ex slavonicarum genere fuisse: sed slavi sero in Illyrium venere, nec ante Justiniani M. tempora. Veteres Illyrii erant Celtici generis, linquaque, ut arbitror, Germanicae Gallicaeque nonnihil cognata utebantur. Et credilibe est ejus reliquias in preculiari quadam lingua Epirotarum hodierna superesse, cujus specimina edita vidi. Slavonicam linguam hodie Illyricam vulgo vocant, quod slavi in Illyrio consedere. Collect. bleu 6. pjesa 2. faqe 197. *(Disa do t'i atribuonin më vonë (alfabetin glagolik) autorit S. Jeronimit nga fisi ilir, me bindjen e gabuar që gjuha antike ilirike ishte sllave: në të vërtetë sllavët erdhën në Iliri, dhe jo para kohës së M. Justinianit. Ilirët e hershëm kishin origjinën*

Iliria e lashtë ndahej në Ilirinë barbare dhe në Ilirinë greke; Iliria barbare mbaronte në Lisso [Lezhë] nëpërmjet lumit Drilo [Drin]; Iliria greke shtrihej nga Lisso [Lezha] deri në Malet Akrokeraune [22].

nga keltët, dhe pas meje, gjuha ngjante disi me gjuhën gjermane dhe kelte. Dhe ndoshta besohet se gjurmë të saj janë dhe në një gjuhë më të veçantë të sotme të epirotëve, shembuj të së cilës i kam parë. Sot gjuhën sllave e quajnë Ilirike, sepse sllavët u vendosën në Iliri.

[22] *Strab. Lib. 7. Kap Dhe duke ecur nëpër plazhet e Ilirisë mbërritëm deri në Malet Keraune, të cilat janë jashtë territorit** [*përkthim i pasigurt, shënim i përkthyesit] *ilir.*

Po ai në të njëjtin vend: *janë epirotë edhe amfilokët dhe të gjithë ata që banojnë ca më lart; si edhe gjithashtu ata që janë të vendosur drejt maleve ilire nëpër zona të thepisura dhe në vende të këqija.* molosët, *edhe* atamanët, etikët, rinfejtë, orestët, parorejtë, *dhe* atintanët*; nga këto populli disa quhen maqedonase, të tjerë në zonën e Jonit...*

Midis këtyre janë të përziera popullsitë ilire, të vendosura drejt maleve të pjesës jugore dhe sipër gjirit të Jonit. Për arsye se sipër Durrësit dhe Apolonisë kanë vendbanimet e tyre bulionët, taulantët, parthinët dhe brigët (brygët), *deri në malet Keraune. Pranë këtyre* lincestët, Deuriopo, Tripoliti, Pelagonia, Leordët, Lamia *dhe* Eratira; *të gjitha vende që më parë ishin shumë më të fuqishme se të tjerat.* Scylax në peripl.: *pas liburnëve vijnë ilirët që banojnë pranë detit deri në Kaoni, e cila është e shkëputur përballë Korfuzit.*

Id. Ibid.: *Ka popullsi ilire aty ku ndodhet* Epidamni. *Oriejtë banojnë në krahinën e Amantias. Dhe amantinët janë ilirë. Nga bulionët e deri te këta shtrihen ilirët. Pranë ilirëve vijnë kaonët.* Dio Cass. lib. 41.: *Durrësi më parë ishte vendosur midis parthinëve, ilirë.*

Tucidide në lib. 1.: *Me Epidamnin janë fqinjë taulantët barbarë, popullsi ilire.*

Stefano: Bullide *qytet bregdetar ilir...* Dasaretët *popullsi ilire....* Partho *qytet ilir.*

Cluerii Introduct. Geograf. antiquae lib. 4. kap. 7. ibi Reiskius: Epirus nova quondam Illiris, Greciae *dicta, neque trans fiumen Acheloum procurrens.*

Leone Alaciusi [Leo Allatius] në shënimet e tij për Akropolitin kap. 21., ku zëvendëson emrat e vjetër të krahinave me emrat e rinj, thotë: *Illyrii, Albanitae. Illyricum quod nunc,* Canicum, e Servia. Dionisio Perlergete *De Mari Adriatico, et Jonio vers.* 388 shprehet kështu: *Illyricam Circa terram volvitur usque ad iugum, montesque excelsos, quos Ceraunios vocant. (Rrotullohet rreth tokes Ilirike deri në majë dhe malet e larta, që i quajnë Keraunë?)* Dhe po aty Eustachio bën shënimin që vijon: *Quod Illiricae regionis terminus praecelsa iuga Ceraunii Montes sunt, ita vocati, eo quod frequenter ibi cadunt fulmina, circa quos sito est novae Epiri metropolis Epidamnus sive Dyrrachium. (Kufiri i krahinës ilirike janë kreshtat e larta, të quajtuara Malet Keraunë, ku shpesh bien rrufe, dhe në këtë vend është Epidamni ose Dyrrahu, metropoli i ri i Epirit.)*

Por rajoni i quajtur *Illirica Greca* nga njerëzit që banonin aty quhej edhe i Maqedonisë, tek e cila bënte pjesë[23].

Epiri zinte, siç e thamë, të gjithë pjesën nga malet Akrokeraune deri matanë Ambrakisë, që sot është Arta. Por, meqë epirotasit kishin të njëjtën gjuhë dhe të njëjtat zakone me popujt e mësipërm ilirë, ata kështu ka të ngjarë që lehtësisht ngatërroheshin e futeshin në mes tyre.

Në realitet shumë nga popujt epirotas ishin të vendosur më sipër Akrokeraunëve; dhe prandaj Straboni në kalimin e cituar më lart thotë një popull ishte i përzier me popullin tjetër.

Por cila ishte gjuha e këtyre popujve? Cilat ishin zakonet e tyre? Flisnin maqedonisht? Kjo është ajo që neve na mbetet për të shqyrtuar.

Nuk ka dyshim se maqedonasit flisnin një gjuhë ndryshe nga greqishtja. Kurci [Curzio, shënim i përkthyesit: Quinto Curzio Rufo, në lat. *Quintus Curtius Rufus*] në bëmat e Aleksandrit shpjegohet kështu: "Ndërkohë mbreti, duke shikuar Filota-n, i tha: maqedonasit duhet të të gjykojnë; po pyes, pra, në qoftë se me ta do të flasësh duke përdorur gjuhën e nënës. Atëherë Filota u përgjigj: në ushtri ka, përveç maqedonasve, shumë të tjerë, të cilët me më shumë lehtësi do të kuptojnë atë që do të them, në qoftë se do të përdor të njëjtën gjuhë në të cilën fole ti" (duke nënkuptuar greqishten)[24]. Dhe diku tjetër po vetë Curzio thotë që Aleksandri e

[23] Dio Cass. d. lib. 41. *Durrësi që më parë ndodhej midis parthinëve ilirë, si edhe tani duhet të përfshihet me Maqedoninë.* Cic. pro Ligario kap. 9. *In Macedonia ad Gn: Pompei castra venit; (Në Maqedoni erdhi në kampin e Gn. Pompeut.)* Ky kamp ishte vendosur pranë Durrësit. Strab. lib. 7. *Disa quajnë Maqedoni të gjithë krahinën deri në Korfuz.* Plin. lib. 3. kap. 23. *A Lisso Macedonia Provincia, gentes Parthini, et a tergo corum Dassaretae.*
(Nga Lisi provinca Maqedoni, fiset partinë, dhe nga prapa dasaretët.)

[24] Lib. 6. kap. 9. *Jamque Rex intuens eum, Macedones, inquit de te judicaturi sunt: quaero, an patrio sermone sis apud eos usurus. Tum Philotas, praeter Macedonas, inquit, plerique adsunt, quos facilius quae dicam percepturos arbitror, si eadem lingua fuero usus, qua tu egisti, non ob aliud, credo, quam ut oratio tua intelligi posset a pluribus. Tum Rex, ecquid videtis, odio etiam sermonis patrii Philotam teneri? Solus quippe fastidit eum dicere. Sed dicat sane utcumque cordis est; dum memineritis, aeque illum a nostro more, atque sermone abhorrere. (Mbreti duke e parë këtë, tha se maqedonasit do të gjykonin ty: kërkoj të di nëse do të përdorësh gjuhën e të parëve. Atëherë Filota, tha se,*

bënte për pesë lekë Filota-n, *që ndërsa kishte lindur maqedonas, me njerëzit e gjuhës së tij merrej vesh nëpërmjet përkthyesit*[25]. Plutarku në fillimin e jetës së Aleksandrit thotë: *Aleksandri lindi ditën e gjashtë të muajit Ecatomeone, që maqedonasit e quajnë Loon.* Dhe po te jeta e Aleksandrit, po vetë Plutarku, duke folur për Klitin thotë që Aleksandri *duke kërcyer përpjetë bërtiti, dhe duke folur në gjuhën maqedonase thirri shqytarët (kjo gjë ishte shenjë e ndonjë trazire të madhe).*

Edhe epirotasit kishin një gjuhë që ishte ndryshe nga greqishtja. Plutarku në fillimin e jetës së Pirros shprehet kështu: *pastaj në Epir Akili pati nderime hyjnore; dhe në gjuhën kombëtare u quajt Aspeto.* Por gjuha epirotase ishte e njëjtë me maqedonishten dhe Straboni jep një dëshmi të qartë: "Disa quajnë Maqedoni të gjithë vendin deri në Korfuz, duke paraqitur si arsye se të gjithë i presin flokët në të njëjtën mënyrë, përdorin të njëjtën gjuhë, përdorin klamidën dhe gjëra të ngjashme; madje pjesa më e madhe janë dygjuhësh". Nga ky citim nga Straboni del në pah se Ilirët përdornin të njëjtën gjuhë si gjuha maqedonase dhe si gjuha epirotase. Duke qenë ata në mes midis Maqedonisë dhe Epirit, dhe duke u folur në mënyrë universale nëpër të gjitha ato rajone një gjuhë, ka vend që të supozohet që të kishin një gjuhë ndryshe? Dhe as nevojitet që të thuhet që disa ishin dygjuhësh; sepse me këtë kuptohet që shumë flisnin gjuhën e nënës dhe greqishten, ashtu siç veprohet edhe sot në shumë vende të Epirit.

Pra, në qoftë se maqedonasit, ilirët dhe epirotasit flisnin të njëjtën gjuhë, por një gjuhë të ndryshme nga greqishtja; nëse ishin të ngjashëm midis tyre, ndryshonin nga grekët; a mund të dyshohet më se shqiptarët e sotëm të jenë rrënjës në vendin që zënë sot dhe që të jenë pasardhësit e vërtetë të atyre kombeve kreshnike dhe fisnike?

përveç maqedonasve, ka shumë të tjerë, të cilët besoj se do të kuptojnë më lehtë ato që do të them, nëse do të kisha përdorur të njëjën gjuhë si tënden, besoj se gjuha jote do të kuptohej nga shumica. Atëherë Mbret, e shihni se Filota tërhiqet nga urrejtja për gjuhën e të parëve? Prandaj, urren qoftë dhe vetëm të flasë. Por le të flasë, vetëm që të jetë nga zemra; mbani mend që ai urrente zakonin dhe gjuhën tonë.)

[25] *Ibid. Kap. II. Po aty Kap. II*

Dhe kjo e vërtetë bëhet më e qartë, kur shohim që disa zakone të lashta, për të cilat na flet historia, janë edhe sot në fuqi pranë të njëjtëve popuj. Ndryshe nga grekët, i prisnin flokët dhe përdornin klamidën[26]; në kuvendet publike duke shkuar aty të armatosur, e jepnin shenjën e miratimit ose të mosmiratimit me heshtë[27]; në banketet e tyre e zgjidhnin sipas dëshirës së tyre vjehrrin[28]; dhe kur donin të bënin ndonjë martesë e prisnin bukën në dysh me shpatë, duke ua dhënë pastaj për të ngrënë nuses dhe dhëndrit[29]. Këto zakone vijojnë të përdoren edhe sot nga ata popuj.

Që pastaj gjuha e sotme shqipe të jetë pikërisht ajo që flisnin maqedonasit, ilirët dhe epirotasit kemi të drejtë të plotë ta mendojmë, megjithëse ndoshta me kalimin e kohës do të ketë pësuar ndonjë ndryshim, siç ka pësuar ndryshime edhe greqishtja. Që nga Arta e deri në Shkodër flitet shqip: prandaj uniformiteti që shihet në vende kaq larg midis tyre, përjashton çdo supozim të ndërrimit të gjuhës. Pas rënies së Perandorisë Greke qytetet e ndryshme të atyre vendeve qenë nën sundimin e pushtuesve të ndryshëm dhe, megjithatë, deri më sot flasin të njëjtën gjuhë. Madje ekzistojnë ende disa nga qytetet e lashta, dhe, edhe tani vazhdojnë të flasin shqip. Scutari [Shkodra][30], Dulcigno [Ulqini][31], Dibria [Dibra][32],

---

[26] *Strab. Loc. cit. Kap.*

[27] Alex. *Genial. dier. lib. 4. kap. II. = Macedonum quoque fuit mos, ut in publica consultatione si quid improbarent, hastis scuta quatientes obstreperent, et aversarentur. (Ishte zakon i maqedonasve, që në konsultimin publik, nëse diçka dënohej, bënin zhurmë me heshta e mburoja dhe largoheshin (shpëtonin).)*

[28] *Curt. lib. 8. Kap.*

[29] *Coel. Rhod. lib.* 4. *Kap.* 12. Këta dy autorë të fundit i ka *Davity Description General de l'Europe;* zëri: *Macedonia.*

[30] Ky qytet në lashtësi quhej *Scodra*, dhe ishte kryeqyteti i Ilirisë Barbare, *Liv. dec. V. lib. 2., e lib. 5.*, Floro de gestis Roman. Te Flori Mbi bëmat e Romakëve lib. 2. Kap. 5. Sot, edhe pse ka ndërruar emrin në *Scutari*, edhe shqiptarët vazhdojnë ta quajnë *Scodra.*

[31] Për Ulqinin, të quajtur nga latinët *Olchinium*, bën fjalë Livi në *decad. V. lib. 5.*; dhe Plini lib. 4. kap. 22. shpjegon me këto fjalë: *Olchinium, quod ante Colchinium dictum est, a Colchis conditum. (Olkini, që më parë thuhej Kolkini, është themeluar nga kolkët.)*

[32] Plin. *Lib. 5 kap. Dyberienses.*

Corona[33], Durazzo [Durrësi], Chimera [Himara] dhe *Drimasi*[34], *Pelagonia*[35], dhe qytete të tjera vazhdojnë të flasin shqip. Bulionët[36], Parthinët[37], Parorejtë[38], *Caonia*, sot Kanina, dhe të tjera akoma ekzistojnë dhe flasin shqip.

Por, në qoftë se duam ta shqyrtojmë më nga afër ngjashmërinë e shqiptarëve modernë me maqedonasit e lashtë dhe me epirotasit, do të gjejmë, me aq sa errësira e historisë na e lejon, jo pak gjurmë nga të cilat të nxjerrim të vërtetën. Sipas Plutarkut, Akili në gjuhën epirotase quhej *Aspetto*; dhe kjo fjalë në gjuhën moderne shqipe duke u shqiptuar *I-Speiti* do të thotë i shpejtë, i gatshëm dhe i përket pikërisht epitetit që Homeri i jep Akilit: ωκυϖδς.

Ecatombeon-i i grekëve përputhet pak a shumë me korrikun e latinëve[39]; tani nga fjalët e Plutarkut të cituara më sipër del që maqedonasit quanin *loon* këtë muaj dhe se shqiptarët modernë vazhdojnë ta quajnë *loonaar*[40]. Në Maqedoni kishte shumë emra të përveçëm me fjalë shqipe: Livi përmend Malin Bora që ndodhet midis Ilirisë dhe Epirit[41]; *bora* në gjuhën shqipe do të thotë 'borë'; dhe mali quhej kështu, sepse ishte gjithmonë plot me borë[42].

Nga sa u tha deri tani, del shumë qartë që Shqipëria e sotme dhe Epiri flasin pikërisht gjuhën e lashtë maqedonase që mund të quhet edhe ilirishte edhe epirotase, ndërsa, siç vumë në dukje më

33 Po Plini, ibid.

34 Për Himarën dhe për Drimasin flet Straboni lib.7. Këto qytete edhe sot përdorin dy gjuhë, domethënë shqipen dhe greqishten.

35 Plin. Loco cit., dhe të tjerë.

36 Këta quhen në gjuhën kombëtare *bullienas*; dhe prej këtej rrjedh mbiemri *Bugliaar*, që do të thotë *gentiluomo*: fisnik, burrë zotëri.

37 Në pjesën më të madhe, mbiemrat e familjeve shqiptare që janë vendosur në Mbretërinë e Napolit janë marrë nga populllsia, nga e cila vetë familjet kanë dalë. Në të vërtetë në Sicili dhe në Kalabri ka shumë shqiptarë me mbiemër *Parrini*, *Partheni* etj.

38 Që në gjuhën shqipe quhen *Pillori.*

39 Salmas. *Exere. Plin. p.* 315.; Scalig-er. *de emend. Temp. 1. f.* 28.

40 *Aar* në gjuhën shqipe është një zgjatje që përdoret shumë shpesh.

41 Liv. *Dec. V. lib. 5.: Quarta Regio Macedoniae trans BORAM Montem, una parte confinis Illyrico, altera Epiro.*

42 Strab. lib. 7. Kap. *"Mbi plazhin ilir ndodhet një krahinë e lartë, malore, e ftohtë dhe plot me borë".*

sipër, epirotasit dhe ilirët grekë përdornin të njëjtën gjuhë[43]. Por, nuk duket se mund të pohohet me siguri në qoftë se Iliria barbare të përdorte të njëjtën gjuhë: ka mundësi, meqë *Scodra* [Shkodra], qytet i vendosur matanë Drinit, dhe që ishte metropoli i Ilirisë barbare, sot flet gjuhën shqipe, Ulqini dhe Dukagjini po ashtu. Por këtu është mirë të përsërisim atë që u tha më sipër, që ndoshta, për arsye të ngjarjeve që kanë ndodhur në kohë, gjuha shqipe të ketë pësuar ndonjë ndryshim. Në fakt hasim në gjuhën shqipe shumë fjalë latine, shumë greke, shumë skite, shumë gjermane, angleze, franceze; por e gjithë kjo nuk duhet të na habisë, meqë afërsia dhe tregtia e epirotasve dhe e maqedonasve me latinët dhe me grekët (një gjë kjo tepër e njohur për historinë) nuk mund të mos prodhonte një përzierje fjalësh. Madje, fakti që shohim kaq shumë fjalë latine në gjuhën shqipe, e përforcon më shumë tezën tonë që ky komb është rrënjës ose të paktën shumë i lashtë si Greqia, dhe jo i ardhur si rezultat i emigracionit në kohët e vona. Të njëjtat arsye të afërsisë dhe të tregtisë me skitët kanë futur në gjuhën shqipe disa fjalë skite. Në pjesën e sipërcituar të Giovanni Comeniata-s shtohen fjalët në vijim: "Afërsia e këtyre trojeve (të skitëve) u leverdis më shumë selanikasve, të cilët prandaj e dëshirojnë me zell tregtinë me skitët, duke pasur një fitim shumë të madh. Veçanërisht, që kur dy kombet merren mirë vesh midis tyre, dhe nuk shkatërrohen duke luftuar më njëri-tjetrin (si bënin më parë), tregtia me anë të shkëmbimit të të mirave është me leverdi të përbashkët, duke ruajtur në mënyrë të ndërsjellë një paqe të gjatë dhe të mrekullueshme[44]. Shumë më

[43] Ja përse me plot arsye Leibnitz-i mendon që gjuha e sotme shqipe është pikërisht gjuha e ilirëve të lashtë. "Ka qenë një kënaqësi e madhe për mua, thotë, që ju më dërguat një libër dhe një fjalor të gjuhës shqipe; nga këto mësojmë se cila ishte gjuha e ilirëve të lashtë. Ndërkohë unë gjej shumë ngjashmëri me latinishten. *Attiune*, për *ati ynë*, ka ngjashmëri me gjuhët skite; dhe duket në të njëjtën mënyrë që ka ndonjë gjurmë të vogël fjalësh që përputhen me gjermanishten, si: *seet*, tokë, *enandeyenie*, me falë, *ndetekech*, në tundim. *Lettera XV. A M. Maturin Veyssiere la Croze, 10. Decembre 1709. Collect. bleu. V. f.* 494. Por duhet të vëmë re se fjalët shqipe të sipërcituara janë shkruar keq. *Atti inn* (padre nostro: *ati ynë*) janë dy fjalë, dhe nuk është një fjalë, dhe prandaj nuk qëndron gjykimi i Leibnitz-it se është një fjalë skite; *dee* (tokë), jo *seet*; *e na ndeyene* (dhe na fal) janë tri fjalë; *nde te kech* (në të keq) janë tri fjalë, meqë *te* është një nyjë. Pra nuk na duket se mund të nxjerrim si përfundim që të ketë lidhje me fjalët gjermane.

[44] De excid. Thessalonic. f. 323. edit. Paris.

pak duhet të bëjë përshtypje prania e fjalëve gjermane, franceze dhe angleze[45]. Unë nuk i futem shqyrtimit imtësisht të mendimit

[45] Nga këto ka një sasi të madhe në gjuhën shqipe. Unë do të vë në dukje disa:

galisht	arbërisht	italisht	përkthimi i italishtes [Shtoj në shtyllën e katërt përkthimin në shqipen e sotme të fjalëve në italishte. Shënim i përkthyesit]
Vnkle	ungl	zio	xhaxha
broches	brech	calzoni	pantallona
sword	cord	spada	shpatë
leq	gliech	gamba	këmbë
feeth	deemb	denti	dhëmbë
brest	bres	petto	gjoks
krees	ghnet	osso della gamba, ginocchio	kockë e këmbës, gju
spittle	pestiim	saliva	pështymë
cough	coll cuol	tosse	kollë
see	sii	occhi o *vedere*	sy, ose me pa; shoh
bald	ball	fronte, o *calvo*	ballë, ose tullac
rond	rodd	correre	me vrapu; vrapoj
sleep	slibb	sonno profondo	gjumë i rëndë
gape	gapp	sbadigliare	gogësij, më hapet goja
tiekle	ticlisse	solleticare	me gudulis; gudulis; giciloj
lose	gliosn	giocare, o perdere	me lujt, me humb; luaj, ose humb
buy	bieen	comprare	me ble; blej
qury	varri	sepolcro	varr
you	jù	voi	ju
open	appn	aprire	me hap; hap
lofty	gliuftaar	guerriero, altiero	luftëtar
sciapc	sciapc	cappello	kapelë
shame	sciaan	vergogna	turp
rip	rip	scorticare, *cuoio*	me rrjep; rrjep; *lëkurë*
hund	gund	naso, cane da caccia	hundë, qen gjuetie
mad, mate	matt	misura	masë
toque	toch	zona virginale	toç, kokë, ballë
door	deer	porta	derë
meal	miel	farina	miell
stir	sctiir	muovere, *gettare*	me lëviz; lëviz; me hedh; hedh
dally	dagll	temporeggiare, adaggio	me fitu kohë; me u vonu; fitoj kohë, vonohem
mud	mut	fango, sterco	baltë, mut
leave	gliee	lasciare	me lënë; lë
milk	miegll	mungere	me mjelë; mjel
hunger	uu	fame	uri
teller	talluur	piatto	pjatë

të Leibnitz-it që beson se ilirët janë të racës kelte, dhe që si pasojë përdornin një gjuhë shumë të afërt me gjermanishten dhe galishten.

Pa u kthyer prapa midis errësirës së lashtësisë (gjë që nuk do të ishte pjesë e detyrës, siç e sqaruam), përsërisim origjinën e këtyre fjalëve nga burime më të vona. Livi thotë që në Maqedoni kishte shumë galë, bujq të palodhur[46]; dhe Justini[47] e prek pushtimin e Maqedonisë prej galëve që nga kohët e Antigonit. Pra këta mund t'u jepnin shumë mirë fjalë si huazime banorëve rrënjës, siç ndodh shumë shpesh. Duchange[48] jep një dëshmi shumë të qartë për

cheese	ghiiz	ricotta, formaggio	gjizë, djathë
crab	crrabb	granchio, uncino	gaforre, grep, çengel, kanxhë
beans	bath	fave	bathë
feuther	fluttur	piuma	pupël
made	math	grande	i madh

[46] Dec. V.lib. 5., "Tertia Regio... habet incolas quoque permultos gallos, et Illyrios, impigros cultores. (Në krahinën e tretë ....ka më shumë banorë galë dhe ilirë, kultivues të zotë.)

[47] Lib. 25. në fillim.

[48] *Famialiae Dalmaticae Sclavonicae Turcicae ec.* kap. 13.: "Serviae vero Regibus paruit (Zenta), donec pessum euntibus Regni rebus, Urosco postremo Rege imperante, sed et post ejus interitum, quidam ex Albaniae proceribus cognomento *Balsa*, ut vir erat audacia, ac fortitudine animi praeditus, hanc provinciam invasit, suisque in posterum heredibusasseruit. Hunc Orbinus ex indigenis nobilibus Albaniae natum dixit: verum *Balsae* cognomen, et quae ipsi familiae adscribuntur insignia, Stella nempe aurea in campo rubeo, satis declarant, ex Italia, ubi sub Andegavensibus Ragni Neapoletani Ragibus summa apud principes auctoritate, ac dignitatibus fulsit, in hasce oras pervenisse, cum Reges iidem in Dalmatiam ascenderunt ac Dyrrachium, vicinaque alia oppida expugnarunt, traductis eo familiis Francicis, seù Franco-Neapolitanis: unde Albani proceres a Franchis ortum se ducere palam profitebantur; ideoque accidit, ut inter Albanos, et Gallos mutuus intercessit semper animorum consensus; iique non semel in Regum nostrorum copias militares relati legantur". (*Familje dalmate sllave turke ec.* Kap.13. "Iu bind mbretërve të ..., deri atëherë kur punët e Mbretërisë të shkonin keq, gjatë mbretërimit të Uroskos, dhe trashëgimtarëve të mëvonshëm, dikush nga fisnikët e Albanisë me emrin *Balsha*, si një burrë me guxim dhe karakter të fortë pushtoi këtë provincë, dhe ua la trashëgimtarëve. Orbino tha se ky ka lindur nga fisnikë vendas të Albanisë: mbiemri i vërtetë *Balsha* dhe simbolet e familjes që i atribuohen, Ylli i artë në fushën e kuqe, pohojnë, nga Italia, ku nën mbretërimin e Anzhuinëve me autoritet të madh mes princave të Mbretërisë së Napolit, dhe shkëlqente nga dinjiteti e kishin mbërritur në këto brigje, kur vetë mbretërit u ngjitën në Dalmaci dhe Dyrrah, dhe pushtuan qytetet e tjera fqinje, nga familje franceze, ose franko-napolitane: nga ku albanët pohojnë hapur se kanë lindur nga frankët; dhe ndodhi që mes albanëve dhe galëve ka pasur një pajtim dypalësh shpirtëror; dhe këto nuk duhen menduar se janë kundër ushtrive e Mbretërve tanë".

kohët që janë më afër nesh. Ai na siguron për komunikimin e vazhdueshëm dhe mbarëvajtjen e marrëveshjes midis galëve dhe shqiptarëve.

Na mbetet për të thënë ndonjë gjë për emrat *Albani* dhe *Albania*. Tolomeu[49] është i pari që përmend emrin e *Albanopoli*-t dhe emrin *Albani*, që ndodhen në Maqedoni. Cellario[50] pastaj thotë "*Albanopolis a solo Ptolomaeo narratur cum gente Albanorum in Macedoniae finibus; quam angustiori limite contentam fuisse oportet, quam nune est ibi Albania"*.[51] Pietro Possino[52] pohon pak a shumë të njëjtën gjë: *"Albanorum Regionem in Macedonia Ptolomaeus agnoscit. Porro antiqua Macedonia postremis hisce Orientalis Imperii senescentis temporibus in quatuor divisa partes, priscum nomen in sola mediterranea retinuerat. Pars vero ejus confinis Dalmatiae et Illyrico, Albania jam tune, uti et hodie, appellabatur: ubi erat Dyrrachiensis Civitas."*[53]

Reiskio[54] shkon pak më tutje, duke shpjeguar me këto fjalë: *Post Epirum Albania, et haec quidem ab excelsis montibus appellata, quos Galli veteres huc delati alpes sua lingua nominaverant. Ita Jacobus Palmerius Graeciae antiqua lib. 1. cap. 14.docet; additque caput Epidamnum esse, vel Dyrrachium, Italis Durazzo.*[55]

---

[49] Lib. 3. kap. 13.

[50] Geograph. lib. II. Kap. 13.

[51] *Rrëfehet vetëm nga Ptolemeu Albanopoli se ishte me fisin e albanëve në kufijtë e Maqedonisë; dhe që duhet të ishte e rrethuar nga kufi më i ngushtë, se ai ku është Albania sot.*

[52] *Ad Pachimer. lib. V. Kap. 7. glossarium verb. Albaniatae.*

[53] *Ptolemeu njeh krahinën e Albanëve në Maqedoni. Më vonë Maqedonia antike në periudhën e fundit të Perandorisë së Lindjes, e ndarë në katër pjesë, e ruajti emrin e vjetër. Në fakt, pjesë e saj në kufijtë e Dalmacisë dhe në Iliri, quhej si edhe sot Albania: ku ishte qytetërimi dyrrakien.*

[54] *Ad Cluerii Introduct. Geograph. antiq. lib. 4. kap. 7.*

[55] *Pas Epirit, Albania, e quajtur nga malet e larta, të cilët galët e vjetër i kishin quajtur Alpe në gjuhën e tyre. Kështu, Jakob Palmeri Mbi Greqinë Antike, lib.1. kap. 14 na mëson: dhe shton se koka është Epidamni, ose Dyrrahu, në italisht Durazzo.*

Kapitulli II

NJË VËSHTRIM MBI HISTORINË E SHQIPTARËVE

Do të ishte përtej idesë sonë dhe përtej rrethit të ngushtë të këtij fjalimi që të bezdisnim lexuesin me të dhëna të ndërlikuara në errësirën e lashtësisë: një lexim i shpejtë i asaj që na kanë lënë në trashëgim autorët më të shquar, do të mjaftojë për të plotësuar temën e paraqitur.

Straboni[56] referon që Theopompi numëronte 14 kombe të epirotëve; dhe pastaj dora-dorës i saktëson, pra: kaonët, mollosët, thesprotët[57], amfilokët [amfilohët], atamanët (midis të cilëve ishin Oricët), ethikët, tinfejtë-i, orestët, parauejtë [paurejtë], atitanët[58], talarët, pelagonët, emiliotët, perrebët [perrebejtë][59]. Disa prej këtyre (shton vetë Straboni)[60] i jepen me më shumë arsye Maqedonisë; disa të tjera i afrohen më shumë gjirit jonian... Me këta popuj pastaj gjenden të përzier popullsitë ilire që janë të vendosura në malet në afërsi të rajonit jugor dhe në bregdetin e Jonit. Në realitet, sipër Epidamnosit, domethënë Durrësit, dhe sipër Apolonisë kanë ngulimet e tyre bullionët, theilazët, parthinët dhe brigët, deri në malet keraune... Pranë këtyre lincestët, deuriopët, palagonia, leordët, limia dhe eratira.

Secili prej këtyre vendeve ishte në të kaluarën shumë i fuqishëm; dhe tek enkelejtë qenë zotër pasardhësit e Kadmosit dhe të

---

56 Lib. 7. pothuajse në fund.
57 Ib.
58 Ibid. më poshtë.
59 Lib. 9. pothuajse në fund.
60 Lib. 7. pothuajse në fund.

Harmonisë, dhe gjërat përrallore që tregohen për ta këtu mund të shihen me sy. Jo të gjitha këto vende kishin zotër që kishin lindur aty, por lincestët qenë nën Arrabenë, që ishte nga fisi i bakiadëve. Mbesë e këtij, (sepse qe e bija e vajzës së tij), qe nëna e Filipit II [Filipi i Amintës], biri i Euridikës; dhe Irra qe e bija e tij (e Arrabeut). Nga epirotët, molosët qenë nën Pirro Neoptolemon, i biri i Akilit, dhe nën pasardhësit e tij që ishin nga Tesalia. Por popujt e tjerë të atij kombi qeveriseshin nga vendës. Pastaj, meqë gjithmonë diçka uzurpohej nga fituesit, gjithçka përfundoi nën sundimin e maqedonasve, por duke përjashtuar vendet që ndodheshin mbi gjirin jonian" (në realitet mbretëria e pirridëve sipër molosëve, tesprotët etj., shpëtuan).

Popullsitë e mësipërme, ashtu siç ishin të fuqishme, para se të viheshin nën zgjedhën e maqedonasve, kishin edhe një qytetërim të themeluar mirë, si edhe një kulturë shumë të mirë. Plutarku[61] na jep një dëshmi të qartë, ndërsa midis mbretërve të lashtë të Epirit përmendte Tarrita-n dhe thotë se ai u bë i famshëm, meqë kishte zbukuruar qytetet me zakonet greke, me letërsi, me ligje të këndshme dhe njerëzore. Tani Tarrita jetoi katër breza përpara Pirros (ai mbreti i shquar i Epirit që lulëzoi pas Aleksandrit të madh dhe që erdhi në Itali kundër romakëve); pra duhet të besojmë që në kohën e Pirros qytetërimi në ato vende ishte i përsosur.

Shkretimi i filluar nga maqedonasit, siç u tha, mbi vendet e Ilirisë dhe të Epirit që nuk ishin të përfshira në mbretërinë e pirridëve, me kohën erdhi dhe u fut edhe në këtë: shkaku qe një e papritur. Pausania e tregon[62]: Punët e tesprotëve në Epir kishin shkuar drejt rrënimit, sepse ishin pa princ; për këtë arsye Deidemia, e bija e Pirros (stërnip i Pirros për të cilin folëm më sipër) nuk pati fëmijë. Prandaj, kur ajo ishte gati për të vdekur ia la populli që të kujdesej për mbretërinë. Sapo epirotët mbetën pa mbret, populli filloi jo vetëm që të sillej me mendjemadhësi dhe pafytyrësisht në punët e tjera, por filloi edhe të përçmonte dhe të mos e kishte frikë

[61] Në jetën e Pirros në fillim.
[62] Në *Messanica* në fund.

autoritetin e magjistratëve. Prandaj ilirët që banojnë sipër Epirit, gjatë bregut të detit Jon, me një sulm të befasishëm i vunë nën zgjedhën e tyre. Në të vërtetë, me sa dimë ne, vetëm athinasit e shtuan fuqinë e tyre, kur shteti iu la në dorë popullit; por athinasit ia dolën mbanë që të kishin kaq shumë fuqi, qoftë sepse ua kaluan grekëve të tjerë në fushën e dijes dhe në shkencën e ekonomisë, por edhe sepse u treguan shumë të bindur karshi ligjeve.

Por nuk mbaruan këtu të këqijat e shqiptarëve. Armët romake i mbaruan së shkatërruari ato rajone. Është me rëndësi për këtë argument të veçantë një kalim i Strabonit[63] që meriton të citohet: "Në shekujt e kaluar pra, shumë prej këtyre popullatave, edhe pse ishin të vogla, dhe jo fisnike, por falë nivelit të shkëlqyeshëm të njerëzve të veçantë, duke u qeverisur vetë prej tyre, nuk ishte e vështirë të dalloje kufijtë e tyre. Por tani duke qenë vendi në pjesën më të madhe i shkretë, dhe fshatrat dhe qytetet të shkatërruara, me të gjithë zellin që njeriu mund të tregojë, asgjë nuk do të japë dobi, duke marrë parasysh mungesën e fisnikërisë dhe shkatërrimin e vendit, i cili duke pas filluar që prej shumë kohësh, nuk është ndërprerë akoma në shumë pjesë për arsye të kryengritjeve të popujve; madje romakët kanë ushtritë në vendin e tyre, meqë vetë janë bërë zotër. Polibi thotë, që Pal Emili shkatërroi nga themelet 70 qytete të epirotëve, pasi mundi maqedonasit dhe Perseon (pjesa më e madhe e këtyre qyteteve ishin të molosëve), dhe që futi në burg 150 mijë veta... Në të kaluarën, siç e thashë, Epiri dhe Iliria, edhe pse të ashpër dhe plot me male (Tamaro, Poliano, dhe shumë të tjerë), kishin prapëseprapë një popullsi shumë të madhe në numër; tani në pjesën më të madhe mbretëron vetmia, dhe banohet në fshatra të vegjël dhe midis gërmadhave.

E kundërshtojnë të gjithë këtë, edhe Lukani[64] dhe Skulaksi[65]; kështu që nuk mbetet ndonjë arsye për të dyshuar.

Por, ndryshe prej tyre, Maqedonia nuk ra kaq shpejt në këtë

[63] Lib. 7. pothuajse në fund.

[64] Lib. 3. ... *et vagus altis (në vende të larta)*

[65] *Në Periplo: "Post Cassiopiam gens Molossorum est, qui et ipsi vicatim habitant". ("Pas Kasiopas është fisi i Molosëve, të cilët banojnë në fshatra").*

barbari të re: meqë qytetërimi kishte bërë hapa të mëdhenj nën një mbretëri që zgjati shumë, dhe as kishte vuajtur shumë pas pushtimit të romakëve, kështu në kohën e perandorëve shohim qytete shumë të lulëzuara në ato vende.

Livi thotë[66] "Tertia regio (Macedoniaie) nobiles urbes Edessam, et Beroeam, et Pellam habet"[67]. Dhe Straboni, duke folur për Selanikun[68], shprehet me këto fjalë: "Thessalonicam oppidum Macedonum, quae supra caeteras hujus aetatis urbes eximia civilitate floret".[69]

Pasi Perandoria Romake nënshtroi gjithçka nën zgjedhën e vet, ato rajone vuajtën të njëjtat pasoja si Greqia; dhe, për rrjedhojë, do të ishte e padobishme të merremi me këtë gjë dhe të themi diçka për historinë e tyre; aq më tepër që përgjatë shumë shekujve shpirtrat njerëzorë nuk u morën me ndonjë gjë tjetër, përveçse me çështjet fetare; në këtë gjë Iliria dhe Maqedonia patën pjesën e tyre, meqë mbetën gjithmonë të lidhura me Patriarkanën e Romës[70].

Pas goditjeve të mëdha të marra nga Perandoria e Kostandinopojës dhe me rënien e kësaj, disa provinca, për të cilat jemi duke folur, shihen të nënshtruara nga sovranët tanë; të tjera shihen nën pushtimin e shteteve të fuqishme jo me pak peshë; dhe të tjera, më së fundi, i vëmë re se janë plotësisht të lira.

Në fakt për atë që ka të bëjë me të parat, dihen pushtimet e Roberto Guiscardo-s mbi Artën, Durrësin, Kastorian [Kosturin][71]. Ruxheri I, pas vdekjes së Boemundit, vëllait të tij, jo vetëm që vazhdoi të sundonte si zot në ato provinca, por e shtriu më tej sundimin e tij[72]. Guljelmi I bëri po të njëjtën gjë[73]. Karli I Anzhu u

[66] Lib. 55. p. m. 306.
[67] "Krahina e tretë, (e Maqedonisë) ka qytetet e bukura Edesan, Beroean dhe Pelën".
[68] Lib. 7.
[69] "Qytetin maqedonas të Thesalonikisë, i cili lulëzon mbi qytetet e tjera të kohës falë qytetërimit të veçantë".
[70] Rodotà *del rito greco in Italia* lib. 3. Kap. 1 §. 3., et seqq. grumbullon të gjithë autorët që kanë të bëjnë me këtë pikë.
[71] Oderic. Vital. *Hist. Eccl.* lib. 3. et 7.
[72] Colen. loc. cit. Sigon. *De Regno Ital. lib.* II.
[73] Colen. loc. cit.

shtoi të drejtave të lashta të drejtat që rridhnin nga martesa e Filipit, djalit të tij, dhe vajzës së Balduinit II, perandor i Kostandinopojës, të cilit ia kishte zhvatur mbretërinë Mikel Paleologu[74]. Më së fundi Karli III, dukë i Durrësit, i ulur në fronin e Napolit, i bashkoi principatat trashëgimtare që kishte në Shqipëri dhe në More[75].

Disa nga fuqitë e mëdha kanë pasur një rol të rëndësishëm në historinë e kombeve. Komnenët e fisit perandorak që sunduan në Durrës, në Vlorë etj., tokët, despotë të Epirit, kastriotët, sunduesit e Imathisë dhe të Kastoria-s [Kosturit]; më së fundi Dukët e Janinës dhe sundues të Etolias, meritojnë që të gjithë një vëmendje të veçantë. Për komnenët dhe për tokët kemi më shumë kujtime në autorët e Mbretërisë së Napolit[76]. Për dukët e Janinës dhe sunduesit e Etolias flet Du-Change[77]; dhe më duket që të jenë po ata të cilët i përmend Pakimeresi[78], duke përdorur këto fjalë: "Kishte (Michele Paleologu) edhe një djalë të lindur jashtë martese me emrin Xhovani, i cili kishte nën komandën e vet forca që nuk mund të mos përfilleshin.

Ky, meqë ishte martuar me të bijën e Tarona-s, ishte princ me të drejtë trashëgimie i një principate me një popullsi të shumtë në numër; dhe duke pasur ushtri të shkëlqyera, dhe duke qenë edhe ai vetë shumë me përvojë në artin ushtarak, ishte i aftë që të bënte çdo orvatje me anë të luftës, në mënyrë që të ndërmerrte çfarëdo veprimi ushtarak. Në realitet ushtria e tij përbëhej nga trupa që i nënshtroheshin atij, që më parë kishin qenë trupa greke, për nga emri dhe për nga prejardhja, dhe që kishin luftuar nën komandën e Akilit; dhe tani quhen *megalo-blakitë* [pra nga Vllahia e Madhe][79].

---

[74] Costanz. Lib. 1.
[75] Costanz. Lib. 4. Giannon. Isl. Civ. lib. 23. në fillim dhe kap. i fundit.
[76] Rodotà *del Rito greco in Ital.* lib. 3. Kap. 2. n. 3.
[77] *Famil. Dalmatichae, Sclavonichae, Turcichae* ec. Kap. 15.
[78] Histor. lib. 1. Kap. 30.
[79] Megalo-blakitët i përmendin edhe Niceta në *Blandruino Flandro* f. 313, Basil., Akropoliti Hist. Sect. 15. f. 23., et sect. 38, p. 33. edit. Reg. Anna Commena etj., të gjithë këta e vendosin këtë popullsi në malet e Tesalisë. Por këta malësorë të Tesalisë janë pikërisht ata që Kantakuzeni quan *Albanë*, ashtu siç do të themi më poshtë.

"Për Kastriotët nuk ka autor që të mos shkruajë[80]; dhe veçanërisht me bëmat e Gjergj Kastriotit, ose Skënderbeut, është plot historia. Ky i fundit, duke arritur 25 fitore kundër Muratit II dhe Mehmetit II, është bërë i pavdekshëm në kujtesën e popujve[81]. Për këtë njeri të shquar do të kemi rastin të flasim më poshtë, kur do të flasim për ardhjen e shqiptarëve në Mbretërinë e Napolit.

Për vendet e lira është me vend të citojmë atë që thonë Pakimeresi dhe Kantakuzeni. Pakimeresi në bëmat e Mikel Paleologut[82] thotë: "Disa ilirë, pasi e shkundën zgjedhën e Perandorit, duke u qeverisur për llogari të vet, dhe duke qëndruar në rrethinat e Durrësit të shkatërruara më parë nga tërmetet[83]; pasi e rindërtuan, vendosën aty një koloni, banorët e së cilës u shtuan nga banorët e vendeve aty afër; dhe u bënë bashkë me mbretin Karl (Anzhu), që mbante aty afër kështjellën e Kaninës". Kantakuzeni pastaj shprehet kështu: "Sirjani (në kohën e Andronikut II) duke kaluar nëpërmjet zotërimeve të Lokrides dhe të Akarnanisë, u strehua pranë albanëve, të cilët banojnë afër Tesalisë, janë njerëz të egër dhe që merren me blegtori dhe që jetojnë me ligjet e tyre"[84]. Dhe diku tjetër, po i njëjti autor, thotë[85]: "ndërsa perandori ishte në Tesali, albanët, që banojnë në malet e asaj krahine dhe që jetojnë pa mbret duke u quajtur: *Malacasi* [malakasë], *bovi* [bovë], *Massareti* [masaretë] nga emri i prijësve të tyre, shkuan që t'i bënin nderimet dhe ishin 12 mijë veta; meqë druheshin se mos shkatërroheshin nga ana e romakëve gjatë dimrit; në fakt duke mos banuar në asnjë

[80] Du-Change loc. cit. Kap. 18 "Costantinus Castriotus, cognomento Meserechus, Aematiae, et Castoriae Principes, vel dominus, memoratur a Flavio Comneno, qui eum obiisse ait an. 1390. Hujus filius Georgius Castriotus. Ilujus filius Johannes Castriotus pater Scanderbeghi". ("Kostandini Kastriot, me nofkën, Meserek, Princat e Ematias dhe Kastorias, ose padroni, përmendet nga Flavio Komeno, i cili thotë se ai ka ikur para 1390. Biri i këtij, Gjergj Kastrioti. Biri i këtij Gjon Kastrioti, babai i Skënderbeut".)

[81] Shih Barlezio, Enea Silvio, Fidelfo dhe të tjerë pa fund.

[82] Lib. 6. Kap. 32.

[83] Duhet vënë re se vetë Pakimeresi pak më parë lib. 5. kap. 7. i kishte quajtur me emrin *albanë* këta që tani quan *ilirë*, të cilët ishin në zonën përreth Durrësit.

[84] Lib. 2. kap. 24.

[85] *ib. Kap. 28.*

qytet, por në zona malore dhe të rrëpirëta, mendonin se mund të shtypeshin lehtësisht në ato male shumë të larta nga i ftohti dhe nga bora.

Pas marrjes së Kostandinopojës fuqia otomane gllabëroi gjithçka; por me gjithë shkretimin e përgjithshëm të përhapur në ato rajone, vendet e lira, të cilat i kemi përmendur, e ruajtën, siç po ruajnë edhe tani pavarësinë e tyre; dhe ne pak më poshtë do të kemi rastin që të flasim sërish për to.

Kapitulli III

ZAKONET E SHQIPTARËVE

Turbullimi i natyrshëm prej barbarëve, kureshtja e pakët, mosnjohja e komoditetit të jetës, mungesa e mjeteve, mungesa e garës janë arsyet kryesore të cilat vonojnë tek ata qytetërimin. Kalojnë shekuj dhe kombe të tëra shihen tek dergjen në ligështim dhe janë të pagdhendura. Dhe as ia dalin mbanë që të shkunden nga një letargji kaq shumë e gjatë, në qoftë se nuk shkunden me forcë nga një dorë e fuqishme. Deri në ditët tona ndoshta grekët do të kishin banuar nëpër pyje dhe midis egërsirave, në qoftë se fenikasit dhe egjiptianët nuk do të kishin futur tek ata kulturën. Romakët, pa ndihmën e grekëve, do të ishin edhe tani tufa kusarësh; italianët, francezët dhe evropianë të tjerë do të jetonin ende në barbari, në qoftë se kryqëzatat ose emigrimi i grekëve nuk do të kishin futur dritën e dijes së Lindjes.

Por, përse kemi turbullirë, nëse veprimtaria është tipar i njerëzve? Prej nga vjen kureshtja e vogël, nëse dashuria për të ditur është e rrënjosur thellë në natyrën tonë? Prej nga ku mungesa e garës, nëse kënaqësia e epërsisë është e pandarë nga natyra e njeriut? Nevojat e pakta të barbarëve bëjnë që këta të mos kenë asnjë idhull tjetër, përveç përtacisë dhe pavarësisë. E para sjell me vete mospërfilljen e gjithçkaje; e dyta prodhon krenarinë dhe luftërat e vazhdueshme. Pra, përveç dashurisë për t'u dalluar në përdorimin e armëve, nuk dallohet tek ata ndonjë ambicie tjetër. Lidhja e pakufishme e barbarëve me pavarësinë dhe me lirinë i bën ata që të jetojnë të lumtur? Liria është e kotë, madje shumë e rrezikshme, aty ku

paqja dhe qetësia e jetës nuk përbëjnë objektin kryesor të saj. Kush vallë mund të pohojë që luftërat e vazhdueshme, kryengritjet dhe grindjet e brendshme mund të përbëjnë një objekt kënaqësie?

Ja përse, pra, popujt për të cilët po flasim, pasi bien në barbari, jetojnë për shumë shekuj të zhytur në barbari; barbaria prodhon gjendjen e luftës; dhe në mënyrë të ndërsjellë këto e nxitin dhe e mbajnë gjallë atë.

Kjo pra është, duke folur në përgjithësi, pozita e të gjithë popujve barbarë; prandaj me urtësi dhe me mend është vënë re nga Robertson-i[86] dhe nga Mario Pagano[87], që zakonet e barbarëve janë të gjitha njësoj; po të vihen në të njëjtat rrethana, gjithmonë shfaqen nën të njëjtën formë. Robertson-i e provon këtë të vërtetë me një paralelizëm të saktë midis gjermanëve të lashtë dhe njerëzve të egër të Amerikës; dhe Mario Pagano nxjerr prej aty argumentet më të rëndësishme të gjendjes të banorëve të parë të Greqisë dhe të Italisë.

Pas mbresave të këtyre njerëzve të mëdhenj do të ishte e kotë të shtonim shqyrtime të tjera dhe sqarime mbi tezën e ngjashmërisë mes barbarëve; por nuk do ta bëja detyrën time, në qoftë se do t'ia haja hakun lexuesit për ato të dhëna, të cilat, të panxjerra në shesh deri tani nga askush, me të drejtë mund t'i interesojnë kureshtjes së tij; dhe unë si bashkatdhetar i këtyre banorëve, për të cilët jam duke folur, duke komunikuar gjithmonë me ta, besoj se i kam mundësitë që ta përmbush këtë detyrim. Pastaj duke referuar për zakonet e shqiptarëve do të sjell në citim pjesët e Taciti-t mbi zakonet e gjermanëve të cilat kanë një përkim të ndërsjellë.

Zakonet e kombit në përgjithësi

Shqiptarët janë me natyrë gazmore; i duan gostitë dhe dëfrimin; kënaqen veçanërisht me vallet. E kanë akoma zakon që të kërcejnë me shpata në dorë, duke kënduar këngë përmbajtja e të cilave flet

[86] *Istoria di Carlo V. Introduz. Shënimi 6. seksioni 1.*
[87] *Saggi politici etc.*

për bëmat luftarake të njerëzve të shquar të kombit[88]; dhe përshtatin zërin dhe gjestet sipas ndodhive për të cilat flitet[89]. Njëlloj si duan gostitë, kënaqen kur japin mikpritjen e tyre[90], (duhen përjashtuar nga ky rregull i përgjithshëm ato vende të mjera që ndodhen në bregdet dhe që jetojnë duke u marrë me pirateri). Duke qenë me natyrë bujare, dhe meqë nuk kujdesen shumë që të grumbullojnë pasuri, ia japin shpejt atë që kanë atij që ua kërkon, por edhe ata vetë kërkojnë po aq lehtë[91]. Në këto gosti vendosin zakonisht çështjet me njëfarë rëndësie; por me të njëjtën shpejtësi që shpalosin ndjenjat e tyre, po ashtu tërhiqen mbrapsht më vonë[92]. Megjithëse

[88] Tacit. de. mor. Germ. Kap. 1. *Celebrant carminibus antiquis (quod unum apud illos memoriae, et annalium genus est) Tuistonem. (Festojnë Tuiston me këngë të vjetra (e cila mbahet mend dhe është një lloj dok. historik))*

[89] Id. Ibid.: *Sunt illis haec quoque carmina, quorum relatu, quem Barditum vocant, accendunt animos, futuraeque pugnae fortunam ipso cantu augurantur; terrent enim, trepidaeque, prout sonuit acies. Nec tam vocis ille, quam virtutis concentus videtur affectatur praecipuae asperitas soni, et fractum murmur objectis ad os scutis, quo plenior, et gravior vox repercussa intumescat. (Janë këto këngë, të cilave u referohen, të cilën e thërrasin Bardit, ndezin shpirtërat, urojnë fat në luftën e ardhshme; frikësojnë siç lëshon zë fronti i betejës. Nuk duket se ndikon zëri aq sa tingulli i virtytit. Ashpërsia e tingullit,murmuritje e mburojave të hedhura, që zëri të bëhet më i lartë më i plotë e i rëndë.)*

[90] Ibid. Kap. 21.: *Convivii, et hospitiis non alia gens effusius indulcet. (Asnjë fis tjetër nuk zbukuron më mirë banketet dhe shtëpitë.)*

[91] Ibid. *Abeunti si quid proposceris concedere moris; et poscendi invicem eadem facilitas.* Id. *Gaudent muneribus, sed nec data imputant, nec acceptis obligantur. (Atij që largohet, u japin cfarë kërkon; dhe me të njëjtën lehtësi i kërkojnë njëri-tjetrit. Kënaqen me dhuratat, por nuk kërkojnë mbrapsht çka japin dhe nuk janë të detyruar t'i pranojnë.)*

[92] id. kap. 22. *Sed et de reconciliandis invicem inimicitiis, et jungentis affinitatibus, et adsciscendis principibus, et de pace denique, ac bello plerumque in conviviis consultant, tanquam nullo magis tempore aut ad simplices cogitationes pateat animus, aut ad magnus incalescat. Gens non astuta nec callida, aperit adhuc secreta pectoris licentia loci. Ergo detecta, et nuda omnium mens postero die retractatur: et salva utriusque temporis ratio est. Deliberant dum fingere nesciunt: constituunt dum errare non possunt. (Por dhe për t'u pajtuar me armiqtë, për të pasur afri, dhe kështu bisedojnë në bankete për paqe dhe për luftra, si për një moment shpirti t'u hapet mendimeve të thjeshta ose të nxehet shumë. Fis as dinak e as hileqar, zbulon sekretet nga kraharori. Kështu, mendja e hapur e të gjithëve rimerret ditën tjetër: dhe arsyeja shpëton për të dy. Mendojnë kur nuk dinë të shtiren: vendosin kur nuk mund të gabojnë.)*

kanë natyrë të paqëndrueshme, janë ama shumë besnikë dhe të kujdesshëm kundrejt mikut, kundrejt pronarit. Janë armiq të çdo shtirjeje ose tradhtie; janë më të saktët në administrimet që u besohen atyre. Por njësoj si të gjithë barbarët e tjerë e quajnë të lejueshme që me armikun të përdorin mashtrimin dhe gënjeshtrën[93].

Nuk janë aspak servilë, madje një shpirt lirie ruhet brenda tyre me gjithë rënien e shkaktuar nga prepotenca dhe nga sundimi i baronëve. Për ta është pothuajse e pamundur që t'i përshtaten ushtrimit të një profesioni. Është më e vështirë të binden që të lërojnë tokën, duke nxjerrë prej kësaj një fitim të qetë e të sigurt, sesa të marrin armët dhe të përleshen me armiqtë; përkundrazi e vlerësojnë si një gjë dembele dhe të vdekur, që të fitosh me djersë atë që mund të fitohet me gjak[94]. I duan gjithmonë gjërat e reja, e

[93] Homeri, si një përshkrues i saktë i zakoneve të barbarëve, u thur shpesh lavde dinakërisë dhe dhelpërive të Uliksit. Madje është e ditur ajo që vetë Minerva i thotë këtij Heroi, pasi e ka qortuar për gënjeshtrat dhe për mashtrimet e tij: *Sed age ne amplius haec dicamus, scientes ambo fraudes; quia tu quidem es hominum quam optimus omnium consilio, et verbis; ego autem in omnibus diis consilioque polleo et fraudibus*: *(Por vepro që të mos themi më këto gjëra, duke i ditur të dyja mashtrimet; sepse ti je pa dyshim më i miri për plane (propozime) dhe për fjalë; përkundrazi kam fuqi te të gjithë zotat, te plani, dhe mashtrimet.)* Od. 13. v. 296. Dhe në lib. 19. v. 395 lavdëron Antolikun i cili ua kalonte të gjithë njerëzve me dhelpëritë e tij dhe se bënte betime që nuk i mbante.
Pra, nuk duhet të na habisin dredhitë e shqiptarëve karshi armiqve; dhe shumë më pak duhet të na bëjë përshtypje ajo çka bëri vetë Gjergj Kastrioti në përputhje me traditën e kombit të tij. "Ndërkaq (thotë Costanzo lib. 20) Kastrioti, që kishte qëndruar me urdhër të mbretit Ferrante guvernator në krahinën e Barit, duke pasur dëshirën që të kryente ndonjë akt në shërbim të mbretit që të binte në sy, duke e parë që qytetit të Trani-t, që ishte shumë besnik ndaj mbretit, i binte në qafë Antonio Josciano, që mbante kështjellën, duke mos mundur që ta rrethonte atë, për arsye se Piccinino ishte afër, pasi e bëri të zbresë në fushë për të zhvilluar bisedime, ndërsa po shëtisnin bashkë, e kapi, e zbriti nga kali, e çoi në kampin e tij dhe e detyroi që ta dorëzonte kështjellën në këmbim të lirisë. Roberto Guiscardo bëri të njëjtën gjë me Pietro di Bisignano-n.
[94] Tacit. Kap. 14. *Nec arare terram, aut expectare annum,* tam facile persuaseris, quam vocare hostes, et vulnera mereri; pigrum quinimmo et iners *videtur sudore acquirere, quod possis sanguine parare. (Mos puno tokën, ose mos prit vitin, të bindesh kaq lehtë, sa të thërrasësh armiqtë, dhe të meritosh plagët; duket se dembeli fiton në djersë atë që mund ta kesh me gjak.)*

urrejnë qetësinë[95]; por, kur nuk kanë rast që të vënë në përdorim armët e tyre, janë njerëzit më të dhënë pas përtacisë[96].

Në çdo kohë janë femrat ato që kujdesen për shtëpinë, qoftë për atë që ka të bëjë me administrimin e brendshëm, qoftë për punën në arë[97]. Pranë shqiptarëve gratë rriten dhe mbahen gjithmonë nën edukimin më të rreptë; prandaj grave nuk u lejohet asnjë dëfrim, edhe pse i vogël që të mund t'i shthurë[98]. Për nderin e tyre ka një xhelozi të tillë, që, në rast se shkelet prej dikujt, nuk ka masë tjetër gjysmake përveç armëve. Dhe prandaj janë të rralla shkeljet e kurorës; edhe veset nuk merren me shaka; dhe as të thyesh me para dhe të jesh i shitur nuk quhet modë[99].

Njerëz luftëtarë, të cilëve gjithashtu nuk u pëlqen gjë tjetër përveç armëve; janë të prirur pas vjedhjeve dhe pas grabitjeve; por, përkundrazi s'e shohin dot me sy çdo lloj vjedhjeje të vogël që është rrjedhojë e ndonjë poshtërsie[100].

---

[95] Id. Ibid. *Ingrata genti quies. (Pushim i pakëndëshëm për fisin.)*

[96] Id. Ibid. *Quoties bella non ineunt, non multum venatibus, illus per otium transigunt, dediti somno, ciboque. Fortissimus quisque ac bellicosissimus nihil agens, delegata domus, et penatium, et agrorum cura feminis, senibusque, et infirmissimo cuique ex familia, ipsi habent: mira diversitate naturae, cum iidem homines sic ament inertiam, et oderint quietem. (Sa herë që nuk ka luftra, nuk shkojnë për gjueti, rrinë pushim dhe flenë e ushqehen. Më i forti dhe më luftaraku nuk bën asgjë. Kanë kujdes për shtëpinë, familjen, për fushat e gruan, dhe për pleqtë dhe të sëmurin në familje.)*

[97] Id. Ibid. *Delegata domus, et penatium, et agrorum cura feminis. (Kujdes për shtëpinë, familjen, për fushat e gruan.)*

[98] Arist. Lib. 1. politic. kap. 1. *Caeterum apud barbaros mulier et servus eodem habentur loco. (Te barbarët në një vend ishte një grua dhe një skllav.)*

[99] Tacit. ibid. kap. 18. *Quamquam severa illic matrimonia; ne ullam morum partem magis laudaveris... Megjithatë* aty ka martesa serioze; të mos lavdërosh asnjë zakon kap. 19. *Ergo septa pudicitia agunt nullis conviviorum irritationibus corruptae... paucissima in tam numerosa gente adulteria, quorum paena praesens, et mariti permissa... nemo enim illic vitia ridet, nec corrumpere, et corrumpi, saeculum vocatur. (Prandaj, veprojnë nisur nga pastërti e pakorruptueshme nga provokime të banketeve... shumë pak tradhti bashkëshortore mes kaq shumë njerëzve, ndëshkimi i të cilave është dhe me lejen e burrit...ne fakt askush nuk qesh me veset, as korrupton e as korruptohet....)*

[100] Id. kap. *materia munificentia per bella, et raptus.* Caes. De Bell. Gal. Lib. 6. *Latrocinia nullam habent infamiam quae extra fines cujusque Civitates fiunt: atque ea juventutis exercendae, ac dissidiae minuendae causa fieri praedicant.*

Nga ana tjetër sot është ulur shumë ky zakon barbar, sidomos midis atyre shqiptarëve që kanë bërë ndonjë hap drejt qytetërimit; por mbeten megjithatë disa doke që ravijëzojnë karakterin, ose mënyrën e veprimit të kombit. Kur dhëndri shkon të marrë nusen, njerëzit që janë me të e shoqërojnë me këngë, duke i thënë, midis të tjerash, që të shkojë me gëzim, sepse nuk shkon në luftë, por po shkon për të grabitur, për të rrëmbyer (një grua); dhe, si të jetë e vërtetë, pastaj bëhet e gjithë ceremonia e rrëmbimit të një gruaje; njerëzit e nuses nuk duan ta hapin derën dhe vetë nusja duhet të rrëmbehet me zor nga shtëpia e saj[101]. Por në qoftë se kjo ceremoni dhe ajo që i këndohet dhëndrit nuk dëshmon gjë tjetër veçse një zakon të lashtë, në atë që pastaj i këndohet nuses gjithçka diktohet nga virtyti dhe nga urtësia. I flitet për kursimin dhe për punët e shtëpisë, për vuajtjen nga lodhja dhe për rreziqet etj[102].

(Bujari përmes luftrave e dhunimeve. Cez. Mbi luftën galike, lib.6. Vjedhjet nuk i konsiderojnë turp sepse ndodhin jashtë kufijve të çdo qyteti: dhe thonë se ato gjëra janë që të ushtrohet rinia dhe të ketë sa më pak shkaqe te mosmarrëveshjes.) Dihet shumë mirë që ky është zakoni i gjithë njerëzve të egjër dhe i barbarëve; prandaj është një gjë e kotë që të sjellim dokumente të tjera.

[101] Edhe romakët pasi ishin qytetëruar në një farë mënyre i ruajtën në kujtesë grabitjet e lashta; dhe gjatë dasmave bëhej ceremonia, ashtu siç vihet në dukje nga epitalami i Katulit:

Collis o Heliconei
Cultor. Uraniae genus,
qui rapis *teneram ad virum*
Virginem, o Hymenee. Hymen.
(Bir i Uranias, banor i kodrës së Elikonës,
ti që i dërgon burrit virgjëreshën e dashur,
o Imene, Imene.)

[102] Tacit. Ibid. *Ne se mulier extra virtutum cogitationes, extraque bellorum casus putet, ipsis incipiendis matrimonii auspiciis admonetur, venire se laborum, periculorumque? sociam, idem in acie, idem in praelio passuram, ausuramque. (Në mënyrë që gruaja të mos mendojë veten jashtë mendimeve për virtytet e as jashtë fatkeqësisë së luftrave, këshillohet për të filluar me ogur për martesën, që do të jetë po ajo që do të vuajë në front, po ajo në beteje dhe do të guxojë të punojë e të jetë në rrezik.)*

Për shqiptarët e lirë

Nuk nevojitet që të bëjmë fjalë këtu për ata shqiptarë, që, pasi u vunë nën zgjedhë nga turqit, tani nuk janë më skllevër të despotizmit otoman, meqë, përveç zakoneve që nuk i interesojnë qeverisë, gjithë pjesa tjetër e fuqisë fituese është shfuqizuar. Do të kufizohem pra me shqiptarët që, ose jetojnë plotësisht të lirë nga Porta, ose që i detyrohen kësaj vetëm me një haraç të vogël dhe janë të lirë për gjithçka.

Këta shqiptarë të pavarur zënë një pjesë të mirë të territorit; dhe, qoftë pse nuk i janë nënshtruar kurrë pushtimit, ose, qoftë pse (siç ka më shumë mundësi të jetë) edhe mbretërit midis tyre kanë ushtruar mbi ta autoritetin vetëm sa quheshin krerët e kombit; ata që nga kohët e lashta bashkë me zakonet barbare kanë ruajtur edhe lirinë. Kantakuzeni, që e shkroi historinë e tij nën Andronikun të riun, i quan *endacakë autonomë*[103], pra njerëz që merren me blegtori dhe që jetojnë me ligjet e tyre; dhe tjetërkund, po i njëjti autor, i quan *αβασιλεντα*, pra, pa mbret[104].

Secili qytet, territor ose fshat jeton më vete; nuk është e lejuar të përzihesh në punët e fqinjëve për çështje që nuk përbëjnë interes të përbashkët. Çështja e përbashkët është çështja e lirisë: ndodh shpesh që pashallarët e turkut ose nga ambicia, ose nga koprracia përpiqen që t'i vënë nën zgjedhë, dhe atëherë bashkohen të gjithë për të luftuar armikun e përbashkët.

Ndarja, që kemi vënë në dukje, e një territori nga një territor tjetër, e një fshati nga një fshat tjetër shkakton luftëra të vazhdueshme. Midis fqinjëve nuk janë të rralla çështjet e ndarjes së territoreve, të shkeljes së të drejtave, të vrasjeve, të vjedhjeve dhe të tjera; dhe të gjitha këto nuk zgjidhen në ndonjë rrugë tjetër, përveçse armëve. Dhe, si rrjedhojë, kemi shkretimin e tokave dhe mjerimin e banorëve. Ja përse qytetërimi është pothuajse i pamundur aty ku nuk i kushtohet vëmendje bashkimit: barbaria prodhon barbari.

[103] Lib. 2. kap. 24.
[104] Lib. 2. kap. 28.

Por, në qoftë se interesat nga qyteti në qytet, nga territori në territor janë të ndara plotësisht, nuk janë më pak të ndara interesat midis familjeve. Secili fshat nuk përbën një grup të përbashkët të vetëm e kompakt, por duke u përbërë nga shumë farefise, ose familje të ndara, që në gjuhën amtare quhen '*cetta*', çdo '*cetta*' e pavarur nga tjetra. Për mosmarrëveshjet që dalin brenda vetë çetës pajtohen nga më të vjetrit; ashtu si edhe për mosmarrëveshjet midis prindërve dhe fëmijëve; të tjerëve, që nuk janë anëtarë të së njëjtës çetë nuk u lejohet që të ndërhyjnë, edhe pse çështja mund të jetë e rëndë; me përjashtim ku kanë interes dhe kur thirren[105]. Sa më e madhe në numër të jetë çeta, po aq është e respektuar. Aty ku jetohet në një gjendje të vazhdueshme lufte, më i forti është gjithmonë më i nderuari, sepse është ai të cilit ia kanë më shumë frikën. Familjet e shumta në numër janë më të forta. Prandaj pranë shqiptarëve nuk vlerësohet beqaria; dhe vëllezërit i japin zemër njëri-tjetrit në mënyrë të ndërsjellë që të martohen[106]; dhe me të drejtë, sepse çeta e tërë merr pjesë për të marrë hak pas më të voglës fyerje që pëson edhe një anëtar i vetëm i saj; kështu që shpesh midis dy ose më shumë çetash ka një luftë të përsosur[107].

Në çdo territor ekziston kuvendi i pleqve. Quhen pleq jo për moshën, por për mençurinë e tyre. Kuvendi i pleqve u ngjan të gjitha kuvendeve të pleqve në vendet barbare; nuk ka ndonjë autoritet ose kompetencë; mblidhet rrallë; dhe nuk ka një kryetar që ta drejtojë. Ndonjë urgjencë publike, ose për të vendosur për ndonjë mosmarrëveshje midis dy ose më shumë çetash janë zakonisht arsyet për thirrjen e mbledhjes; por në shumicën e rasteve

[105] Tacit... *Suam quisque sedem, suos penates regit. (Secili sundon vendin e vet, paraardhësit e vet.)*
[106] Id. Kap. 20. *Quanto plus propinquorum, quo major affinum numerus, tanto gratiosior senectus, nec ulla orbitatis pretia. (Sa më i madh numri i familjarëve, sa më i madh numri i të afërmve, aq më e hijshme është pleqëria, asnjë çmim i të qenit pa fëmijë.*
[107] Kap. 21. *Suscipere tam inimicitias seù Patris, seù propinqui, quam amicitia necesse est. (Është e nevojshme të kesh si armiqësinë e Babait, ose të të afërmit, si miqësinë.)*

ndodh që pleqtë të largohen pa përfunduar asgjë[108]. Mblidhen të armatosur dhe me armë japin pëlqimin ose mendimin e kundërt për atë që propozohet. Urgjenca e përgjithshme, të cilën kuvendi mund të marrë në shqyrtim është ose lufta, ose paqja, ose kur me kërkesë të përbashkët duhet të shpallet ndonjë statut, ose kur për interesin e përbashkët duhet ngarkuar me punë ndonjë dërgatë, ose, më së fundi, kur duhet dënuar një fajtor për tradhti të lartë ndaj atdheut, ose për ndjenja të reja fetare. Jashtë këtyre rasteve nuk ka autoritet publik; dhe ajo çka shkakton çudi është fakti që, për të njëjtat krime, aty ku nuk cenohet interesi i të tretëve, as publiku nuk merret me to, dhe as kuvendi nuk ka asnjë të drejtë kundër fajtorëve. Pra nuk parashikohet ndonjë dënim as për blasfeminë, as për simoninë, as për benë e rreme, as për dështimet që mund t'i shkaktohen një femre, që nuk është gruaja e dikujt dhe as atëvrasjet. Por ai që është fajtor për këto krime, nuk ia vlen më të jetojë, sepse neveria dhe urrejtja e publikut e katandisin keq dhe ia plasin shpirtin deri në fund.

Lufta është objekti kryesor i gjithë kujdesit të tyre: janë pothuajse gjithmonë në armiqësi midis tyre ose me vendet fqinje, dhe gjithmonë të përqendruar për të kundërshtuar sulmet e pashallarëve; ia vënë mendjen vetëm ushtrimeve të trupit, stërvitjes fizike dhe përdorimit të armëve. Të gjithë janë ushtarë, mjafton që t'ua lejojë shëndeti ose

[108] Omer. Odyss. Lib. 2 v. 24. - 33, v. 198 - 203. v. 246 - 250. Tacit. *Illud ex libertate vitium, quod non simul, nec jussi conveniunt, sed et alter, et tertius dies contatione coentium absumitur. Ut turbae placuit, considunt armati. Silentium per Secerdotes, quibus tum et coercendi jus est, imperatur. Mox rex vel Princeps, prout aetas cuique, prout nobilitas, prout decus bellorum, prout facundia est, audiuntur, auctoritate suadendi magis, quam jubendi potestate. Si displicuit sententia, fremitu aspernantur: sin placuit, frameas concutiunt. Honoratissimus assensus genus est armis laudare. (Kjo gjë vjen se janë të lirë të vendosin kur të mblidhen, dhe shtyhet për tri ditë për shkak të vonesës së të ftuarve. Si ta pëlqejë turma, të armatosurit zënë vend. Urdhërohet heshtje nga Priftërinjtë,të cilët kanë të drejtë të detyrojnë. Më vonë, mbreti ose i pari, si është çdo kohë, fisnikëri, lavdi e luftrave, të folurit, dëgjohen nga autoriteti për të bindur sesa nga pushteti për të urdhëruar. Nëse vendimi nuk pëlqehet, hidhet poshte me zhurmë: nëse u pëlqen, tundin shpatat. Miratimi më i nderuar është lavdërimi me armë.)*

mosha. Pa asnjë shpërblim secili prej tyre e ndien veten të detyruar që të paraqitet në betejë me kurajën më të madhe dhe me shpejtësi; dashuria për lavdinë, frika nga çnderimi është shtytja që përcakton veprimet më të vështira. Ai që shpëton gjallë nga një përleshje duke u larguar prej përleshjes nga paburrëria, ose ai që, në kohën kur po ngarendej drejt luftimit, është fshehur me anë të një mashtrimi, nuk ia vlen më të jetojë[109]. Kanë dëshirë që të ndeshen dhe e duan vdekjen ata që mund të kenë fatin që të vdesin për atdheun; dhe vetë prindërit e quajnë për krenari që të kenë bij të tillë.

Meqë nuk kanë mbret, i zgjedhin çdo herë në rast nevoje kryetarët e tyre, që bëhen udhëheqës në luftë. As autoriteti, as juridiksioni nuk i bën ata të respektueshëm: por me gatishmërinë e tyre, me vënien e të gjitha forcave në dispozicion të shokëve, me shembullin e tyre duhet të bien në sy; këto janë arsyet me të cilat duhet t'i mbajnë ngjitur pas vetes shokët[110].

Në betejë nuk i vënë radhët në rregull, dhe as nuk rrinë pa lëvizur në pozicionin e vet: lëvizin herë këtu, herë atje duke u derdhur aty ku besojnë që mund ta mbytin armikun[111]. Kolonat formohen nga anëtarë të së njëjtës çetë, të cilët përpiqen që të rrinë gjithmonë të bashkuar, me qëllim që të janë sa më të aftë për çdo veprim[112].

[109] Tac. *Scutum reliquisse praecipuum flagitium, nec aut sacris adesse, aut concilium inhire ignominioso fas, multique superstites bellorum, infamiam laqueo finierunt. (Është krim të kesh lënë mburojën, nuk u është e lejueshme as të shenjtëve, e as këshillit të dëshirojë këtë turp, dhe shumë të mbijetuar nga luftrat, i kanë dhënë fund turpit.)*

[110] Tacit. ib. *Ed duces exemplo potius, quam imperio, si prompti, si conspicui; si ante aciem agant, admiratione praesunt. (Dhe komandantët vlejnë më shumë për shembullin që japin, sesa për urdhrin: nëse veprojnë në rresht të parë, shihen me admirim.)*

[111] Pontan. *Cum Italici equites statariae magis pugnae sint assueti propter armorum gravitatem, contra Macedones ex Turcarum disciplina vagi procursantesque raro congrediantur stantes. (Duke qenë se kalorësit italikë janë mësuar me luftimin në një vend për shkak të peshës së armëve, kundër maqedonasve që enden nën disiplinën e turqve duke vrapuar rrallë luftojnë duke qëndruar në këmbë.)*

[112] Tacit. ib. *Quodque praecipuum fortitudinis incitamentum est, non casus, nec fortuita conglobatio turmam, aut cuneum facit, sed familiae, et propinquitates. (Shtysa kryesore e forcës nuk është fatkeqësia, as grumbullim i rastësishëm, nuk bën një çetë ose një skuadër, por familjet dhe të afërmit.)*

Edhe femrat marrin pjesë në luftë: shpesh vihen përpara radhëve, që të jenë si paramur për armikun, duke qenë i mahnitshëm nderimi i thellë i të gjithë barbarëve ndaj seksit të dobët". Shpesh, nga rendin për t'u shkuar në ndihmë të afërmve me ushqim, me municion dhe me gjëra të tjera. Më në fund, shpesh me vajtime, me lutje dhe me qortime, u japin kurajë luftëtarëve dhe u ndryshojnë fatin betejave[113].

Aty ku autoriteti i kuvendit nuk ka të drejtë, gjithçka i lihet në dorë hakmarrjes private. Një vrasje, një shkelje e besnikërisë bashkëshortore, një vjedhje, një ushtrim dhune bën lesh e li të gjithë zonën e banuar, qytetin a fshatin, duke vënë në gjendje lufte dy ose më shumë çeta.

Kur ndodh një vrasje, anëtarët e çetës së të vdekurit, pa pasur parasysh përse ka ndodhur, nëse ka ndodhur rastësisht, për fajin e dikujt, nëse ka qenë një veprim me dashje apo jo, mendojnë se kanë të drejtën që të shkretojnë të gjitha pronat e çetës së vrasësit dhe që të vrasin çdo anëtar të kësaj çete; dhe nuk hiqet dorë nga atentatet, deri kur ta ulë zemërimin ose vrasja e fajtorit, ose vrasja e dikujt tjetër të çetës së tij, ose pajtimi nga ana e miqve, dhe e pleqve të kuvendit, të cilët në atë rast vendosin gjobën në para dhe në mall[114].

Rreptësia e dënimit për shkeljen e kurorës bën që shkeljet e

[113] Tac. *in proximo pignora, unde foeminarum ululatus audiri, unde vagitus infantium; hi cuique sanctissimi testes, hi maximi laudatores. Ad matres, ad Conjuges vulnera ferunt; nec illae numerare, aut exsugere plagas pavent. Cibumque, et hortamina pugnantibus gestant. Memoriae proditur quasdam acies inclinatas jam, et labantes a foeminis restitutas constantia precum, et objectu puerorum. (Pastaj janë lidhjet familjare, ku dëgjohen vajtimet e grave, të qarat e fëmijëve; këta janë dëshmitarët më të nderuar, lavdëruesit më të mëdhenj. U sjellin plagë nënave, bashkëshorteve; dhe nuk druhen as të numërojnë plagët, e as të pastrojnë plagët. Sjellin ushqim dhe inkurajim për luftëtarët. Thuhet se disa radhë të ushtrisë janë tërhequr, ato që binin ringriheshin nga gratë falë lutjeve të vazhdueshme dhe mbrojtjes me kraharor.)*

[114] Tac. *Nec implacabiles durant etc. (inimicitiae); luitur enim homicidium certo armentorum ac pecorum numero, recipitque satisfactionem universa domus, utiliter in publicum, quia periculosiores sunt inimicitia juxta libertatem. ((armiqësitë) e pamëshirshme nuk zgjasin; në fakt është dënuar për vrasje të një kopeje dhe numrit të bagëtive, dhe e gjithë shtëpia mirëpret kënaqësi, më mirë mes njerëzve, sepse armiqësitë afër lirisë janë më të rrezikshme.)*

besnikërisë bashkëshortore të jenë shumë të rralla. Burri ka të drejtë të vrasë pa i hyrë ferrë në këmbë shkelësin e besnikërisë bashkëshortore dhe shkelësen e besnikërisë bashkëshortore[115]; madje, meqë shkelësi i besnikërisë bashkëshortore konsiderohet si autori kryesor i krimit, çeta e tij, jo vetëm që nuk ka asnjë të drejtë që t'i ngelet hatri, por, për më tepër, është dorëzanë për një vrasje tjetër kundrejt çetës së cilës i përkiste shkelësja e besnikërisë bashkëshortore e vdekur.

Edhe ushtrimi i dhunës mbi njerëzit krijon gjendjen e luftës midis dy çetave; por nuk është kështu për atentatet që cenojnë mallin, kjo gjë shkakton shpagimin dhëmb për dhëmb. Dhe kështu veprohet edhe për vjedhjet, edhe pse në atë pikë i gjithë kombi shqiptar është shumë i butë, siç e vumë në dukje më sipër.

Të gjitha mosmarrëveshjet e tjera private shpesh (thjesht sipas dëshirës së ndërgjyqësve) i besohen gjykimit të kuvendit të pleqve. Këta, pas drekës që palët u kanë përgatitur atyre, vendosin për çështjen; e kanë zakon që si shpërblim të kenë më tepër një palë këpucë.

Prindërit i lidhin martesat për fëmijët që kur këta janë në djep; dhe këto nuk mund të zgjidhen më pa një arsye që ta justifikojë këtë gjë.

Prikën nuk ia jep gruaja burrit, siç e kemi ne zakon, por burri ia jep babait të nuses[116]. Edhe pse autoriteti i burrit mbi bashkëshorten është i pafund, gruaja nuk lirohet nga pushteti atëror; prej nga del se gjendja e grave në ato vende është shumë e keqe. Zgjidhja e martesës dhe lënia e nuses lejohet kur ka arsye që e justifikojnë këtë gjë: por këto më parë duhen shqyrtuar nga pleqtë e të dy familjeve. Ceremonia e shkurorëzimit është që të presësh në mes një litar të vogël, duke i ngelur një pjesë në dorë të burrit dhe pjesa tjetër në dorën e nuses.

---

[115] *Paucissima in tam numerosa gente adulteria, quorum paena praesents, et maritis permissa. (Shumë pak tradhti mes kaq shumë njerëzve, ndëshkimi ekziston dhe u lejohet buarrave.)*

[116] Tacit. ib. *Dotem non uxor marito, sed uxori maritus offert. (Nuk i jep gruaja pajë, por burri ia dhuron.)*

Pushteti atëror është shumë i kufizuar: përveç këshillave dhe ndëshkimit të kufizuar, babai nuk ka ndonjë autoritet tjetër mbi fëmijët; dhe padrejtësia e këtij statuti barbar është një gjë e rëndësishme, ndërsa më lart u tha që nuk ka një autoritet që ta ndëshkojë fëmijën për atëvrasje; përkundrazi, në qoftë se një baba vret ose plagos të birin, çeta e nënës të këtij të fundit është gati të marrë hak. Dhe, kur një bir do të ndahet nga babai, ky i fundit nuk mund ta pengojë këtë gjë, por, përkundrazi, duhet t'i japë pjesën e pasurisë që i përket të birit, duke llogaritur në ndarjen në pjesë të pasurisë të gjithë njerëzit (edhe femrat) që gjenden në të njëjtën shtëpi.

Nuk ka testamente, dhe rekomandohet vetëm ndonjë akt që favorizon personin tjetër të cilit i lihet pasuria, kur kjo nuk i lihet trashëgimtarit. Fëmijët, dhe, në mungesë të tyre, fisi nga babai janë trashëgimtarët e pandryshueshëm të secilit[117]. Gratë, vajzat, edhe pse janë të bijat, nuk kanë asnjë të drejtë të zënë vendin e babait.

Nuk ka funerale. Gratë, përreth të vdekurit, duke qarë i këndojnë dhe i thurin lëvdata të vdekurit dhe i ngrenë lart bëmat. Pasi e varrosin të vdekurin, të afërmit duke shoqëruar zinë, qëndrojnë për disa ditë në shtëpinë e trashëgimtarit, i cili duhet t'i mbajë mirë me darka e me dreka plot salltanet. Shpejt reshtin lotët, por shokët, miqtë e të vdekurit, duke e mbajtur gjatë dhimbjen, për një vit të tërë, çdo ditë në mëngjes, pranë shtëpisë së tij, duhet të japin një shenjë për zinë e vet me një ulërimë[118].

---

[117] Tacit. ib. *Haredes tamen, successoresque sui cuique liberi, et nullum testamentum. Si liberi non sunt, proximus gradus in possessione, fratres, patrui, avunculi. (Megjithatë, trashëgimatrët dhe fëmijët dhe asnjë testament. Nëse nuk ka fëmijë, vijnë të tjerët sipas radhës, vëllezërit, dajat, xhaxhallarët.)*

[118] Ib. ib. *Funerum nulla ambitio... Lamenta, et lacrymas cito; dolorem, et tristitiam tardè ponunt. Foeminis lugere honestum est; viris meminisse. (Asnjë fjalë e mirë në funerale... Rënkime dhe lot;*
Shfaqin vetëm dhimbje e trishtim. Femrat duhet të qajnë, burrat duhet të kujtojnë.)

Kapitulli IV

KOLONITË E SHQIPTARËVE NË MBRETËRINË E NAPOLIT HISTORIA E VENDOSJES SË TYRE, NUMRI I TYRE DHE GJENDJA E TYRE SHKAQET E PËRPARIMIT TË NGADALTË QË KANË BËRË NË KULTURË

Shqiptarët që jetojnë tani në Mbretërinë e Napolit dhe që erdhën në periudha të ndryshme në fundin e shekullit XV dhe në fillimin e shekullit XVI nuk duhet t'i ngatërrojmë me grekët, të cilët që nga kohë shumë të lashta gjenden në provincat tona. Ka një numër shumë të madh në Kalabrinë e përtejme dhe në Territorin e Otranto-s; por, meqë i kam vënë vetes si synim që të flas vetëm për kolonitë shqiptare, nuk futem në temën e grekëve, që për lashtësinë e tyre që shkon larg në kohë, mund të quhen shumë mirë rrënjës të këtij trualli.

Pas vdekjes së Skënderbeut të madh, mbështetjes së vetme të të krishterëve kundër fuqisë së pakundërshtueshme të turqve, dhe heroi i vërtetë dhe pasardhësi i denjë i Pirros dhe i emrit të Aleksandrit[119] (për të përdorur fjalët e Volaterrano-s[120]), shqiptarët, pasi e humbën prijësin e tyre të pathyeshëm, ranë në pikëllim. Të rënë moralisht nga forca e Mehmetit dhe të ndodhur para tërbimit të tij për shkak të humbjeve të shumta që i kishin shkaktuar, nuk gjetën rrugëdalje tjetër, përveçse të iknin dhe të gjenin strehim në Mbretërinë e Napolit. Është e vajtueshme të lexosh për gjendjen e atyre njerëzve në një situatë të tillë: Papa Pali II në letrën drejtuar

[119] Gjergj Kastriotit, kur mbahej peng nga Murati II, iu ngjit ofiqi *Skanderbeg*, që do të thotë *Zoti Alessandre*.
[120] Ap. Raynald. an. 1458 n. 14.

Filipit, dukës së Borgonjës jep ndonjë ide[121]; dhe ne nuk do të mundeshim të mos i përtëritnim në kujtesën tonë fatkeqësi të tilla me shumë dhimbje. Ferdinandi I, për arsye të politikës së drejtë që ia frymëzonte urtësia e tij dhe për arsye të mirënjohjes për ndihmat që i kishte dhënë Skënderbeu, u dha të ikurve një strehim të sigurt. Por periudha e kalimit të tyre në Mbretërinë e Napolit nuk mund të caktohet përgjithësisht në një kohë të përcaktuar. Herë më pak, herë më shumë; nganjëherë trupa të udhëhequra nga një kapedan, dhe nganjëherë në numër më të vogël pa prijës dilnin në brigjet tona. Të parët u dukën në vitin 1461, kur Skënderbeut iu dhanë nga mbreti Ferdinand prona mbi territorin e San Pietro-s në Galatina, ku midis familjeve që la aty, ajo që mbante mbiemrin 'Basta' u bë e kamur dhe më e lartë në rang sesa të tjerat, përsa i përket lavdisë dhe përsa i përket emrit. Shqiptarë të tjerë erdhën pas vitit 1467, vit në të cilin mbaroi jeta e princit të tyre. Të tjerë erdhën gjatë pontifikatit të Palit II që e qeverisi Selinë e Shenjtë nga viti 1464 deri në vitin 1471. Të tjerë erdhën rreth vitit 1478, vit në të cilin Sulltani i madh u bë zot absolut i Epirit, i Maqedonisë dhe i Shqipërisë[122].

Por këtyre emigrimeve duhet t'u shtohen emigrimet e tjera që u bënë në vitet e periudhës së Karlit V. Neveria e shqiptarëve ndaj tiranisë osmane dhe prirja drejt sovranëve të Napolit, që në pjesën

[121] *Albanenses partim caesi gladio sunt, partim in miseram servitutem abducti. Oppida, quae antea pro nobis Turcorum substinuerunt impetus, in ditionem eorum venerunt. Vicinae partes, quae Adriaticum mare attingunt, propinque motu exterritae, tremunt. Ubique pavor,*
ubique lactus, ubique mors, et captivitas ante ocùlos sunt. Audire miserum est, quanta omnium rerum sit conturbatio. Lacrymabile, inspicere navigia fugentium, ad Italos portus appellere, familias quoque egentes pulsas sedibus suis passim sedere per littora, manusque in coelum tendentes lamentationibus suis cuncta implere. (Shqipatërt një pjesë u vranë, një pjesë kaluan në skllavëri. Qytetet që më parë ndalën hovin e turqve, ranë në sundimin e tyre. Pjesët afër, që lagen nga deti Adriatik, tmerrohen. Frikë kudo, vdekje kudo, dhe para syve pushtim. Është e mjerueshme të dëgjosh, sa rrëmujë është kudo. Është për të qarë, të shohësh anijet e vogla që largohen, shkojnë në portet e Italisë, të shohësh familjet e varfra tek dalin nga shtëpite e tyre dhe shpërndarë në brigje, me duar drejt qiellit duke mbushur me rënkime.)

[122] Kështu shprehet Rodotà në lib. 3. kap. 3 te *Rito Greco in Italia.*

më të madhe ishin zotërit e tyre të lashtë, i shtynë që në vitin 1532 t'ia jepnin qytetin e Corone-s atij perandori. Por më vonë, pasi ky qytet u mposht nga forca e turqve, banorëve të Corone-s iu desh që të largoheshin; dhe Karli V që përmendëm më lart, jo vetëm u dha strehë në Mbretërinë e Napolit, por i trajtoi mirë e bujarisht për besnikërinë e tyre dhe për afeksionin e tyre, siç do të themi në vijim. Në periudhën e Filipit II shqiptarët vazhduan që të vinin, deri kur pastaj mbretëria ra në dorë të mëkëmbësve të mbretit, që interesoheshin pak për të mirën publike, dhe pa politikë i linin pas dore interesat e kombit; kështu ardhja u shqiptarëve u ndërpre.

Fshatrat shqiptarë që ekzistojnë tani janë 62 në numër dhe së bashku përfshijnë 66 720 frymë[123]. Unë ndiej detyrimin që të jap këtu të dhënat e tyre me një tabelë të popullsisë së tyre, të ritit, të dioqezës dhe të provincës.

Calabria ultra: Kalabria qendrore-jugore

Emrat e fshatrave	*dioqeza*	*riti*	*popullsia*
Amato	Nicastro	katolik	1 399
Andali	Belcastro	katolik	702
Arietta	S. Severina	katolik	210
Casalnuovo	Gerace	katolik	589
Vena	Nicastro	katolik	707
Zangarona	Nicastro	katolik	724
Pallagorio	Cariati	katolik	900
S. Nicola dell'alto	Cariati	katolik	1 100
Carfizzi	Cariati	katolik	800

[123] Kjo shifër që jepet nga autori nuk mund të jetë ajo e tanishmja e popullatës të kolonive shqiptare, sepse numri është rritur shumë. *Shënim i botuesit F.M.*

Calabria citra: Kalabria veriore

Emrat e fshatrave	dioqeza	riti	popullsia
Acquaformosa	Cassano	grek	1 200
Castoreggio	Anglona	grek	350
Cavallarizzo	S. Marco	katolik	550
Cervicato	S. Marco	katolik	1 050
Cerzeto	S. Marco	katolik	512
Civita	Cassano	grek	1 456
Falconara	Tropea	katolik	1 556
Farneta	Anglona	grek	254
Firmo	Cassano	grek	947
Frascineto	Cassano	grek	1 588
			--
			9 463
Lungro	Cassano	grek	2 555
Macchia	Rossano	grek	463
Marri	Bisignano	grek	300
Mongrassano	S. Marco	katolik	1 200
Plataci	Cassano	grek	1 400
Porcile	Cassano	grek	540
Rota	Bisignano	katolik	804
S. Basilio	Cassano	grek	1 481
S. Benedetto Ullano	Bisignano	grek	1 312
S. Caterina	S. Marco	katolik	838
S. Cosmo	Rossano	grek	506
S. Demetrio	Rossano	grek	1 488
S. Giacomo	Bisignano	katolik	738
S. Giorgio	Russano	grek	1 178
S. Lorenzo	Rossano	katolik	905

S. Martino	Bisignano	katolik	1 090
S. Sofia	Bisignano	grek	1 180
Serra di Leo	S. Marco	katolik	271
Spezzano	Rossano	katolik	1674
Vacarizzo	Rossano	grek	971
			---
			20 894

Basilicata: Bazilikatë

Emrat e fshatrave	dioqeza	riti	popullsia
Barile	Matera	katolik	3 218
Brindisi	Matera	katolik	2 042
Casalnuovo di Noja	Anglona	grek	868
Maschite	Matera	katolik	2 741
S. Costantino	Anglona	grek	1 096

Capitanata: Kapitanata

Emrat e fshatrave	dioqeza	riti	popullsia
Campomarino	Larino	katolik	912
Chiusi	Larino	katolik	1 200
Casalnuovo	Volturara	katolik	1 800
Casalvecchio	Volturara	katolik	1 600
Porto Cannone	Larino	katolik	500
S. Croce di Migliano	Larino	katolik	3 180
S. Paolo	S. Savero	katolik	2 800
Ururi	Lrino	katolik	1 218
			---
			13 210

Terra d'Otranto

Emrat e fshatrave	dioqeza	riti	popullsia
Facciano	Taranto	katolik	1 000
Martignano	Otranto	katolik	584
Monte-parano	Taranto	katolik	700
Roccaforzata	Taranto	katolik	300
S. Giorgio	Taranto	katolik	1 215
S. Martino	Taranto	katolik	320
S. Marzano	Taranto	katolik	730
Sternazia	Otranto	katolik	1 236
Zollino	Otranto	katolik	574
			---
			6 659

Abruzzo ultra Provinca e Teramo-s

Emrat e fshatrave	dioqeza	riti	popullsia
Badessa	Penne	grek	214

Ka shumë fshatra të tjerë që, duke e humbur gjuhën shqipe dhe ritin grek, tani nuk dallohen më nga italianët.

Sicilia: Sicili

Emrat e fshatrave	dioqeza	riti	popullsia
Bronte	Monreale	katolik	
Contessa	Girgenti	grek	
Mezzojuso	Palermo	grek	
Palazzo-Adriano	Girgenti	grek	
Piana	Monreale	grek	

S. Angelo	Girgenti	grek	
S. Michele	Siracusa	katolik	

Nga e gjithë kjo gjë kushdo kupton që kjo çështje nuk mund të jetë një temë e parëndësishme në sytë e qeverisë; dhe prandaj, me të drejtë, kurdoherë ka tërhequr vëmendjen e sovranëve, qoftë sepse një popullsi e tillë tërheq me të drejtë kujdesin e atij, të cilin nuk e zë gjumi për të mirën e shtetit, qoftë sepse koloni të tjera të joshura me mjete të tilla mund të jenë pasuri e pashtershme për popullsinë e paktë të mbretërisë.

Por, nuk duhet të fsheh që kujdesi i treguar deri tani nga sovranët në të mirë të shqiptarëve të mbretërisë nuk ka qenë i mjaftueshëm për t'i nxjerrë nga të qenët të pagdhendur dhe nga varfëria. Me të vërtetë, të çudit fakti që se si treqind e ca vite qëndrim në një vend të kulturuar të mos kenë mjaftuar që të qytetërojnë njerëz jo pa aftësi dhe jo pa energji. Duke qenë kjo një pikë shumë tërheqëse për t'u trajtuar, sa për t'u dhënë një ndihmë kolonive të tanishme, aq edhe për t'u shmangur vështirësitë kolonive të ardhshme, unë do të shqyrtoj shkurt shkaqet e të këqijave, kurse, po u njohën këto shkaqe, është e lehtë të gjesh rrugëdalje.

Ashtu si e thamë më sipër, shqiptarët nuk kanë ardhur në këtë mbretëri të gjithë në të njëjtën kohë: emigrime të ndryshme në epoka të ndryshme kanë krijuar ngulimet e ndryshme që janë vendosur nëpër provinca. Ashtu si do të shqyrtojmë hollësisht më poshtë, Alfonsi i Aragonës qe i pari që filloi t'i pranonte në zotërimet e tij; për këtë arsye, kur vendi qeverisej nga pasardhësit e tij, erdhi një numër shumë i madh i këtyre njerëzve, jo të gjithë së bashku, por në periudha të ndryshme, dhe në grupe të vogla. Pasojë e kësaj ka qenë fakti që shqiptarët e pranuar në Mbretërinë e Napolit nuk formuan ndonjë qytet ku të rrinin bashkë, por të shpërndarë nëpër provinca në fshatra të vegjël, nuk kanë përbërë kurrë një korpus të vetëm që të meritonte vëmendje të veçantë.

Në këtë rënie ka ndikuar për më tepër edhe politika e gabuar e

mëkëmbësve të mbretit dhe mungesa e një territori të gjerë bosh, që të mund të mbante kaq shumë njerëz. Ndërkohë tani pozita është e mjerueshme, ndërsa fatkeqësisht dihet mirë se në të gjitha historitë, që të qenët të shpërndarë në fshatra të vegjël mban dhe përjetëson barbarinë dhe varfërinë.

Përveç kësaj zakonet ndryshe, mungesa e kulturës dhe jeta e tërë ushtarake e shqiptarëve të ardhur në Mbretërinë e Napolit në fillim bëri që ata të duken përpara vendasve si njerëz të frikshëm dhe të pashoqërueshëm. Këto ide kaq të ngulitura në vijim kanë shkaktuar një antipati dhe pastaj armiqësi të ndërsjella. Nga kjo gjë ka buruar ftohja e plotë e shpirtrave dhe mungesa e çdo marrëdhënieje; dhe kjo formoi jo vetëm një pengesë për qytetërimin e shqiptarëve por, për më tepër, nxiti te këta banditizmin, pengesë e përjetshme e çdo kulture.

Pasi u larguan nga trojet e veta shqiptarët mundën të sillnin këtu vetëm shpatën. Pra, pa të holla, pa mbrojtje dhe pa inkurajim si do të mund të punonin tokat, si mund të zgjidhnin një profesion dhe të rrisnin cilësinë e jetës?

Vetë tokat që kanë marrë përkohësisht nga baronët ose nga kishat, në vend që të ishin për kolonitë shqiptare një objekt pasurie, i kanë mjeruar edhe më shumë dhe i kanë bërë pothuajse të egra. Përveç faktit që pjesa më madhe e këtyre tokave ishin toka shterpë dhe të parëndësishme, dihet mirë edhe fakti tjetër, që duke mos qenë pronar i tokës, duke mos mundur të mbjellësh pemë, duke mos mundur të ruash barin për bagëtinë tënde, janë gjëra që shkatërrojnë dhe asgjësojnë çdolloj pune të zellshme.

Baronët dhe kishat në vend që t'i mbronin shqiptarët që përbënin pasurinë e tyre, i kanë rënduar mjaft më tepër me shumë shtypje, që të llahtarisin kur i dëgjon. Detyrimet feudale [krh.it. *angaria* dhe *parangaria,* shënim i përkthyesit], shërbimet e paligjshme etj., nuk mund të mos i ligështonin bujqit dhe bënin që kombi të dergjej në varfëri.

Aty ku i gjithë juridiksioni mbi ngulimet ka qenë i baronëve, atëherë despotizmi nga njëra anë dhe depresioni nga ana tjetër e

kanë bërë të mjerë të gjithë vendin. Madje, aty ku juridiksioni ka qenë i ndarë, pra juridiksioni civil ka qenë i kishës dhe juridiksioni penal ka qenë i baronit laik, atje shthurja e banorëve, mosdënimi i krimeve dhe makutëria e zyrtarëve e kanë mbajtur gjithmonë në rrëmujë popullatën.

Vetë qeveria, e shtyrë më shumë nga interesat tatimorë sesa nga synimet politike, ka ndikuar në varfërimin e shqiptarëve. Duke mos pasur fonde dhe duke mos pasur ndonjë pronë, kolonitë e reja nuk duhet të ishin ngarkuar me taksa njësoj si qytetet e pasura italiane: ishte një gjë jokonsekuente dhe kontradiktore caktimi i taksave doganore sipas numrit të zjarreve, në kohën kur në mbretëri janë shumë fshatra që kanë një territor shumë të gjerë dhe ku një pakicë ka pasuri të pafund dhe shumica është pa tokë dhe në varfëri.

Pa zanat dhe pa punë, nuk mund të kenë para; prandaj duhet të nxjerrin gjithçka nga prodhimet e vogla bujqësore, dhe kështu varfërohen pa shpresë se do të marrin veten. Meqë nevoja për të shitur e detyron bujkun që ta ulë çmimin e prodhimit të tij: çmimi i ulët nuk është kurrë fitimdhënës, përveçse kur është fryt i një bollëku të madh dhe vijimi i një gjallërie të skajshme në tregti.

Mungesa e shkollave dhe e arsimit i bëri që të dergjen në injorancë për më shumë se 200 vjet, faktor që e shtoi barbarinë e tyre. Me ngritjen e Kolegjit italo-grek në San Benedetto Ullano në vitin 1734 u çel një fije shprese, por mjetet ishin shumë të pakta për të plotësuar nevojat e një kombi barbar dhe të mjeruar. Këto vërejtje nuk i shpëtuan mendjemprehtësisë shumë fisnike të Don Giuseppe Zurlo-s, atëherë kur vendosi që ta përmirësonte gjendjen e kolegjit, siç do të thuhet më poshtë. Dhe në realitet, në qoftë se fatkeqësitë e mëdha të vitit 1799 dhe të vitit 1806 nuk do t'i kishin penguar këto plane, ne do të kishim parë të gjithë efektin e tyre pozitiv. Ipeshkvijtë katolikë, në dioqezat ku ishin vendosur shqiptarët, në vend që të nxitnin këto studime, që të rrisnin nivelin e kulturës, që të mbronin dijen, të mbronin profesionet, për arsye të një feje të kuptuar keq, nuk janë kujdesur për gjë tjetër, përveçse për të hedhur poshtë ritin grek të përdorur prej tyre. Nga

kjo gjë kanë ndodhur pastaj grindje të përjetshme dhe armiqësi të ndërsjella, që duke ndikuar në depresionin gjithmonë e më të madh të shqiptarëve, e shtuan tek ata urrejtjen e jetës së qytetëruar, të dijes dhe të zanateve. Në vitet e kaluara qeveria e kohës solli një ngulim të ri grekësh dhe shqiptarësh që u vendosën në qytetin e Brindizit; por, ndërsa u kujdes që të shmangte çrregullimet që kishin ndodhur në ngulimet e tjera për shkaqet që i thamë më sipër, u ndesh me të tjera pengesa. Të ardhurit e rinj ishin njerëz përtacë, grindavecë dhe që pa pasur ndonjë zanat, jetonin duke u marrë me pirateri dhe kontrabandë; pra, ishte e pamundur që t'i bëje të merreshin me bujqësi përnjëherë. Nëse kur thirren ngulime në mbretëri, do të mund të bëheshin zgjedhje, gjithmonë do të duhej të parapëlqeheshin prindërit me familje, dhe jo vagabondët; do të duhej të gjendeshin njerëz që merren me bujqësi, dhe jo njerëz që merren me luftë. Por, meqë ka shumë pak të ngjarë që të mund të përdoret ky zell e këto kritere, dhe të paktën për koloninë e Brindizit kjo duhej të ishte një normë, sipas së cilës bujqit nuk duhej të ndihmoheshin përditë me të holla, që shpenzohen, por u duhej dhënë atyre tokë, shtëpi dhe bagëti në mënyrë të harmonishme secilës familje, u duheshin dhënë përjashtimet e arsyeshme nga taksat dhe privilegjet për atë kohë që mendohet se është koha e duhur.

Këto janë arsyet se pse ngulimet e shqiptarëve të vendosura në Mbretërinë e Napolit nuk kanë bërë përparime në kulturë. Do të mjaftonte të hiqje ato pengesa, që të shihej të lulëzonte një komb që është i aftë të bëjë gjërat më të mëdha dhe që të shihej se si shtohej në mbretëri numri i njerëzve të mirë dhe besnikë.

Kapitulli V

RËNDËSIA E MBROJTJES SË KËSAJ POPULLSIE DHE RËNDËSIA E PRANIMIT TË NJË SASIE TJETËR SHQIPTARËSH. - MJETET E GJETURA NGA QEVERIA E KALUAR PËR TË PËRMIRËSUAR GJENDJEN E SAJ

Ashtu si Esperia jonë dhe si Epiri juaj
janë kaq pranë, dhe si të dyja tokat
të jenë afër dhe motra, dhe të dyja do të kenë
Dardano-n si atë, dhe për fat,
të njëjtin fat; kështu të dyja
do t'i vë qëllim vetes, që me shpirt dhe me zemër
të jemi një Trojë: dhe kjo gjë qoftë
detyrimi i nipave tanë[124]

Këto ishin kushtet që i shkonin për shtat Enea-s së devotshëm; dhe monarkia e Napolit, edhe pse që nga fillimet e saj të ishte

[124] Ky është përkthimi i vargjeve të Virgjilit Æneid. Lib. 3. v. 502 seqq. i Annibal Caro-s, por origjinali është më shprehës:

Cognatasq. Urbes olim, populsq. Propinquos
Epiro hesteria, quibus idem Dardanus auctor,
Atque idem casus, unam faciemus utramque
Trojam animis; maneat nostros ea cura nepotes.

Vërejmë se Virgjili, kur thotë *Esperia*, e ka fjalën për Italinë, dhe në mënyrë të veçantë për Mbretërinë e Napolit; qytetet e lashta të Mbretërisë së Napolit e kanë të njëjtën origjinë nga Epiri. Plini në Lib. 3 kap. 11 të historisë së tij na thotë se *nëntë të rinj me nëntë virgjëresha duke kaluar nga ilirët bijuan trembëdhjetë popuj*. Me emrin ilirë quan epirotasit, ndërsa po aty thotë *Illirica urbe Dyrrachii.*

ngarkuar që t'i vinte në jetë, ia ka lënë këtë zbatim një qeverie të urtë dhe të madhe.

Janë shumë të lashta të drejtat që Kurora e Napolit ka mbi Epirin, mbi Shqipërinë dhe mbi Maqedoninë, siç e shqyrtuam hollësisht më sipër[125]. Prandaj, me një arsye të patundur, mbreti katolik Karli III, duke e shpallur si kombëtar Regjimentin Mbretëror Maqedonas të përbërë nga shqiptarë, u shpreh me këto fjalë: "Mbreti, duke pasur parasysh të drejtën e sundimit mbi territoret e grekëve prej të cilëve përbëhet Regjimenti Mbretëror Maqedonas i këmbësorisë, si edhe të drejtën e vasalëve të ligjshëm, që për këtë arsye përputhet me të drejtën e sundimit, vendosi dhe shpalli që i sipërpërmenduri Regjimenti Mbretëror Maqedonas të konsiderohet si një korpus italian dhe që duhet të gëzojë për këtë arsye ato privilegje dhe ato të drejta që i përkasin[126]". Pra, kur do të viheshin në zbatim këto të drejta, një operacion i tillë do të jepte pa dyshim lumturinë e përbashkët, duke hequr në një komb të ashpër teprimet e barbarisë dhe duke përhapur kulturën dhe mjeshtëritë; dhe, nga ana tjetër, do të na siguronte neve ardhjen e njerëzve luftarakë dhe besnikë, përveç leverdisë së shtrirjes së zotërimit dhe të komunikimit të ndërsjellë dhe tregtisë.

Por, për aq kohë sa ky operacion fisnik të mos vihet në zbatim, i ka hije një mbreti që të mos lërë pa bërë asgjë nga ajo çka ndihmon kombin e vet dhe veçanërisht kur paraardhësit e tij nuk kanë gabuar në gjithçka, ose e kanë përvijuar rrugën pjesërisht. Një mbretëri, që për nga shtrirja dhe për sa i përket pjellorisë së tokave të saj do të ishte në gjendje të mbante dymbëdhjetë milionë banorë, dhe që tani ka në gjirin e vet vetëm pesë milionë, me të drejtë ka tërhequr vëmendjen e qeverisë për të futur me anë të shtimit të popullsisë begatinë e qytetarëve dhe të qenët mirë për shëndetin të zonave të saj. Përkundrazi është vënë re nga përvoja se mjetet për të rritur numrin e banorëve vendas janë gjithmonë të ngadalta dhe shpesh të pafrytshme, duke marrë parasysh kushtet jo të mira të mbretërisë;

[125] Shih f. 34. - 35.

[126] Jepet ky njoftim në *Dissertazione Istorica-cronologica del Reggimento Real Macedone:* Bologna 1767, f. 45.

ja përse me anë të një politike të thellë vëmendja është drejtuar jashtë shtetit për të zgjidhur problemin, për ta arritur atë qëllim aq të dobishëm.

Që nga koha e mbretërve aragonezë ishte mësuar kjo e vërtetë; dhe urtësia e atyre princave kishte filluar të jepte të gjitha udhëzimet për të thirrur të huajt për t'i bërë ballë problemit të numrit të zvogëluar të popullsisë. Dhe pikërisht vëmendja e tyre ishte drejtuar gjithmonë te shqiptarët, që ishin i vetmi popull për të cilin afërsia me provincat tona dhe përndjekja nga ana e turqve e bënte të lehtë emigrimin nga trojet e etërve.

Alfonsi I, që më parë kishte vendosur tri koloni përpara vitit 1448, duke u dhënë si pasuri toka, privilegje dhe kishte zgjedhur nga radhët e tyre shumë trupa për ushtrinë e tij, edhe pse, si u tha më lart, në përdorimin e armëve nuk ka njerëz më të zotë se shqiptarët. Për këtë arsye prijësi i tyre Demetrio Reres u dekorua me një diplomë mbretërore; është mirë të shohim e të dëgjojmë tonin e kësaj diplome:[127]Alfonsi, për hir të Zotit, mbret i Aragonës etj., duke marrë parasysh që me shërbimet e tua ushtarake, e tregove veten, si udhëheqës i tri kolonive Epirotase, gjatë shërbimit tonë ushtarak me gjakderdhje në të gjithë provincën e Kalabrisë së poshtme, gati dhe për shërbime e mundësi të tjera, dhe ke qenë i gatshëm bashkë me bijtë e tu, Giorgio dhe Basilio, dhe Giorgio qëndron tashmë në mbretërinë tonë të Sicilisë përtej Faros në shërbimin tonë si Udhëheqës i qytetarëve tanë Epirotas për mbrojtje nga pushtimet galike, të ashtuquajturës mbretëri, për shpërblim të të cilave, dhe për fisnikërinë tënde të hershme, e cila e ka origjinën nga familja shumë e njohur e princit Kastriot të Epirotasve, është menduar mirë nga ti që të zgjedhësh ushtarin Demetrio Rere dhe të zgjedhësh Guvernatorin tonë mbretëror të provincës sonë të Kalabrisë së poshtme; kështu, sipas protokollit tonë mbretëror zgjedhim, bëjmë dhe të emërojmë guvernatorin tonë mbretëror të provincës së quajtur Kalabria e Poshtme.[128]

[127] Përmbledhja e kësaj diplome është paraqitur në Palermo në datën 24 shtator të vitit 1665 në aktet e Noterit Diego Barretta.

[128] *Alphonsus Dei gratia Rex Aragonum etc... Considerantes nos enim, quod*

Ferdinandi I, duke ndjekur gjurmët e të atit, nuk la pa përdorur as rastin më të vogël për t'i bërë për vete shqiptarët; aq më tepër sepse këtyre dhe princit të tyre Gjergj Kastriotit Skënderbeut ai ia detyronte shpëtimin e mbretërisë, kur baronët kryengritës po bënin kërdinë[129]. Pra, përveçse i dhuroi atij zotërimet e dukatës së Ferrandina-s dhe të markezatit të Tripalda-s[130], por, për më tepër, pas vdekjes së tij, mirëpriti të birin, dhe këtij të fundit, si të gjithë të tjerëve që erdhën këtu, u dha strehim të sigurt dhe i mbushi me privilegje. Të gjithë autorët tanë i përmendin këto privilegje, në sajë të të cilave shqiptarët gjithmonë kanë pasur një trajtim të veçantë dhe kanë qenë të shkarkuar nga çdo lloj takse, nga çdo tatim dhe nga çdo dhuratë[131]. Vetëm si zakon ishte futur rregulli që çdo zjarr të paguante njëmbëdhjetë karlinë për çdo vit; por kjo gjë u bë për shqiptarët që nuk ishin koronej, kurse për këta të fundit përjashtimi nga taksat qe i përgjithshëm dhe absolut[132].

tuis militaribus servitiis et laboribus, uti trium Coloniarum Epirotarum Dux, sub nostro militari servitio cum sanguinis effusione in sdeptione totius provinciae Calabriae inferioris magnopere adhibuisti, aliisque occasionibusbet servitiis paratus, et promptus semper fuisti insimul cum Georgio, et Basilio filiis tuis, qui Georgius ad praesens manet in nostro Regno Siciliae ultra Pharum in servitio nostro tanquam Dux Epirotarum nostrorum subditorum pro defensione praedicti Regni ex gallicis invasionibus, pro quorum remuneratione, ac tua antiqua nobilitate, qua ex clarissima familia Castriota Epirotarum principeoriginem traxit, visum est pro modo te militem Demetrium Reres eligere, et nominare in nostrum regium Gubernatorem praedicta nostrae provinciae inferioris Calabriae; prout virtute praesentis nostrae regiae cedulae eligimus, creamus, et numinamus te in praedictum nostrum regium gubernatorem praenotatae provinciae inferioris Calabriae.

[129] Pontan. *de bell. Neapolitan. Lib. 2.* Costanz. *lib. 20.*

[130] Barletio *lib. 10.*

[131] Shih Scipion. Mazzell. *në descript. Regn. Neapol. lib. 2., Reg. Salernit. dec. 40., dhe ivi Thor, në addit., Novar. në pragm. 1 de appret. n. 23, collect, 2.,* Camill. de Curt. *në divers. feudal. n. 33.*

[132] Regjistri Moles.§.1. de collect. n. 103 për taksën e përmendur prej njëmbëdhjetë karlinësh llogarit të gjitha zjarret e familjeve shqiptare të vendosura në provincat e tjera; por nuk përmend asnjë nga Kalabria veriore (Calabria citra), pikërisht sepse të gjithë shqiptarët e Kalabrisë veriore ishin koronej: ja fjalët e tij: *Sunt autem Villae istae in Postremo advertendum censeo in causa Baronis Roccae Sforzata pro Casalibus Albanensium novissime fuisse judicatum per Regiam Cameram pro immunitate respectu donativorum, licet in*

Karli V i nderoi shqiptarët koronej me shumë diploma dhe i mbuloi me benefite; veçanërisht me statutin mbretëror të lëshuar në Gjenovë më 8 prill 1533 ia la porosi mëkëmbësit të mbretit të kësaj mbretërie, duke i quajtur kalorës dhe duke i përjashtuar nga çdo taksë[133].

privilegio non adesset talis clausula, et non esset ita amplum, quemadmodum privilegium hujus Civitatis (Iserniae); et quatenus diceret decretum in illa causa continere clausulam, dummodo praedicti Albanenses non essent alibi numerati, hoc fuit quia in privilegio consimilis clausula aderat, ad quam decretum voluit se referre. Regno numero... et sunt focularia plicite in statu praesentis anni 1569 num 3944, videlicet in Provincia Comitatus Molisii focularia 102 in principatu ultra focularia 56., in Basilicata focularia 787., in Calabria ultra focularia 153., in Terra Hidrunti focolaria 803, in Provincia Terrae Bari focularia 1186, in Capitanata focularia 1169, in Aprutio ultra focularia 138 in Aprutio citra focularia 403. In caeteris Provinciis non reperiuntur descripta; et sunt in totum num. 3944 pro quibus exigit Curia annis singulis ad rationem carolenorum undecim pro focolario ducatos 4338.2. (Këto qytete janë, mendoj se në rastin e Baronit të Rokas Sforazatës për Kazalët e Shqipatërëve, ishte menduar së fundmi nga Dhoma Mbretërore për imunitet ndaj dhuratave, edhe pse një klauzolë e tillë nuk ishte në privilegj, dhe nuk ishte kaq i shtrirë si privilegj i këtij shteti (Isernia); dhe kur tha se dekreti në atë rast përmban një klauzolë, me kusht që Shqiptarët të mos numëroheshin gjetiu, kjo gjë ishte sepse në priviliegj ishte një klauzolë e ngjashme me atë së cilës dontet'i referohej dekreti. Sipas numrit... janë shtepi në këtë vit, pra 1959 rreth 3944, pra në Provinvcën e Molisit 102 shtepi, në Provincën përtej 56 shtëpi, në Bazilikatë 787 shtëpi, në Kalabrinë Veriore 153, në Tokën E Hidrunitt 803, në Provincën e Terra Bari 1186, në Kapitanata 1169, në Abbrucon përtej 138, në Abrucon jugor 403. Në provincat e tjera nuk kanë dalë akte; janë gjithsej 3944 për të cilat Kuria kërkon çdo vit, si të gjykohej, 11 për shtëpi 4338.2 dukatë.)

[133] Njoftimi ka këtë përmbajtje:

EL REY – *Ill. Marques primo nuostro* [sic] *Virrej y Lugarteniente y Capitan general, como veries por una nuestra Carta nos hemos accordado, de embiar A esse Reyno ciertos Cavalleros, que an venido de Coron, y Patras, y de aquellas comarcas, para que, non else entretengan, hasta pue se ofresca, en que puodan servir ordenandos, che les Sennaleis algunas caserias, y Tterras en Pulla, o Calabria, ò en otra parte de esse Reyno, donde, os pareciere, que mejor, podran vivir, y sosenerse, y proveair, que sean por aora asta, que ordenomos, otra cosa. Libres de pagamientos fiscales, y de otras qualesquieres derechos, porque mejor se puodan entretener, como mas largamente se contiene en la dicha nuestra Carta. Uno de los suso dichos Demetrio Fachimsio Griego del Castillo de Tornes, y porque, nuestra voluntad, es, que, con el se compla lo que por la dicha nuestra Carta os tenemos escripto, seguto dicho es, os encargamus, y mandamos, que luogo, como, esta veais, les senaleis, conforme*

Më pas, e njëjta gjë u vendos me një diplomë zyrtare që përmbante privilegjin dhe që u dërgua më datë 18 korrik 1534 dhe që u fut në zbatim nga Dhoma Mbretërore më datë 3 mars 1538[134]. Ky privilegj mbeti në fuqi për shumë kohë; në kohën që

à ello, Caserias, y Tierras, en que puedan vivir, con sus hijos, y gente, y familia, que era sigo ha trajdo, proveyendo que asta que, ordenemos otra Cosa sean libres de pegamientos Fiscales, y otros qualesquieres derechos, y que de nuestra Thesoreria de esse Reyno, se le den, y paguen en cadeun ano, desde el dia de la data de essa, en adelante, durante nuestro beneplacito settanta ducados de moneda de esse Reyno de que nos le hemos decho, y hasemos, merced por la presiente, que tal es nuestra voluntade, y para ello, os damos nuestro entero, y bastante poder y saremos servido, que lo tengais por encomiendado en esto, y en todo lo que mas le toccare la presiente restituid al presentante. Dat. en. Gennu â 8 de April 1533. - YO EL REY – Locos Com. Major Sec. - Mai Vic. - Sar Suer Corta gr. Per ta... All Ill. Marques de Villafranca muestro primo Virrey Lurgateniente [sic] *y Capitan General en nuestro Reno de Napoles.*

(MBRETI – *Markez, kushëriri ynë [sic]^Mëmkëmbës i Mbretit dhe Komandant i Përgjithshëm, siç do të shihni në Letrën Tonë, kemi rënë dakord t'i dërgojmë asaj Mbretërie disa Fisnikë që kanë ardhur nga Koroni dhe Patras e nga ato krahina, me qëllim që të mos i ndaloni e madje, t'u ofrohet, ku të mund të shërbejnë të komanduar*, që t'u jepen ferma e toka në Pulia ose në Kalabri, apo në pjesë të tjera të asaj Mbretërie ku mendoni se mund të jetojnë më mirë, të jenë në gjendje të mbajnë veten dhe të kujdeseni që të qëndrojnë për momentin deri sa të urdhërojmë tjetër gjë, dhe të jenë të çliruar nga çdo detyrim fiskal dhe çfarëdolloj tjetër e drejte me qëllim që të rregullohen sa më mirë, sikundër thuhet gjerësisht në këtë Letër tonën.*

Njëri nga të sipërpermendurit, Demetrio Fachimsio Griego del Castillo de Tornes, është vullneti ynë që me të të përmbushet gjithë sa shkruhet në këtë Letër tonën, ku thuhet se ju ngarkojmë dhe ju urdhërojmë që, sapo ta shihni këtë letër, t´i jepni, në përputhje me sa thuhet në të, Ferma e Toka ku të mund të jetojnë me fëmijët e tyre, me njerëzit dhe familjet që kanë sjellë me vete, duke u kujdesur që, deri sa të urdhërojmë tjetër gjë, të jenë të lirë nga detyrimet fiskale dhe çdo e drejtë tjetër dhe, gjithashtu, nga Thesari ynë i asaj Mbretërie, t´i paguhen çdo vit, duke filluar nga data e letrës e më tutje, përsa kohë kanë pëlqimin tonë, shtatëdhjetë dukatë në monedhën e asaj Mbretërie, ku ju kemi thënë dhe ju bëjmë me dije nëpërmjet kësaj letre se ky është vullneti ynë, e, për këtë arsye, ju japim pushtet të plotë e të mjaftueshëm për të vepruar dhe kështu do të jetë përmbushur vullnetin ynë, të cilin e kemi shprehur në ketë letër dhe për çka që mungon në të, kërkojini informacion prurësit. Në Xhenova, më 8 prill 1533. – UNË MBRETI – Locos Com. Major Sec. - Mai Vic. - Sar Suer Corta gr. Per ta... . Markezit të Villafranca-s, kushëririt tonë, Mëkëmbës i Mbretit dhe Komandant i Përgjithshëm i Mbretërisë tonë të Napolit.)

[134] Është i regjistruar në Arkivin e Dhomës Mbretërore ["Regia Camera della

shqiptarët e provincave të tjera ishin të ngarkuar me taksa me masën njëmbëdhjetë karlinë për çdo zjarr, shqiptarët e Kalabrisë veriore nuk llogariteshin, ashtu siç u tha më lart. Për këtë përjashtim të plotë nga taksat të Koronejve flet edhe Scipione Costanzo në një dokument të lëshuar për qytetin i Isernia-s që citohet nga Ageta[135].

Ndërsa ky perandor në këtë mënyrë rriste numrin e popullsisë duke pritur mirë dhe duke u dhënë benefite të huajve, nga ana tjetër nuk e largonte vëmendjen nga rezultati më i afërt, që shteti mund të merrte nga një komb luftarak. Meqë ushtria ishte për shqiptarët i vetmi profesion i përshtatshëm, ai pati shumë kompani me ushtarë shqiptarë duke i përdorur me shumë sukses. Paolo Giovio[136] flet për *Demetrio Capuzzimadio, Chiucchiaro*-n, *Teodoro Biscari*-n, kapitenë, kalorës shqiptarë që ishin në shërbim të Perandorit. Dhe dihet edhe se, pasi shqiptarët u futën në Itali, shumë ishin kapedanë mercenarësh, sipas traditës së asaj kohe; dhe vetë Giovio[137] përmend

Sommaria" (rreth 1269-1806); një organ administrativ, juridiksional dhe konsultativ që veproi gjatë periudhës së anzhuinëve dhe të aragonezëve në Mbretërinë e Napolit, shënim i përkthyesit], dhe kopjet autentike gjenden në shumë procese, ku po e njëjta Gjykatë ka dekretuar në mënyrë të veçantë në aktet për *fisnikët Koronej të Barile-s* pranë kancelarit [krh. it. 'attuario' ose 'mastro d'atti': zyrtar, që në Napoli pranonte, regjistronte ose ruante aktet gjyqësore; edhe 'kancelar' dhe 'noter'] Antonio Orsini, në aktet për *Koronejtë e S. Costantino-s* pranë Innocenzo Maria Peloso-s, në aktet për *Koronejtë e Brindizit* pranë Peloso-s të sipërcituar etj.

[135] *Ad Moles de adoha §. 4. q. 4. n. 34: Postremo advertendum censeo in causa Baronis Roccae Sforzata pro Casalibus Albanensium novissime fuisse judicatum per Regiam Cameram pro immunitate respectu donativorum, licet in privilegio non adesset talis clausula, et non esset ita amplum, quemadmodum privilegium hujus Civitatis (Iserniae); et quatenus diceret decretum in illa causa continere clausulam, dummodo praedicti Albanenses non essent alibi numerati, hoc fuit quia in privilegio consimilis clausula aderat, ad quam decretum voluitsse referre. (Në fund mendoj se në rastin e Baronit të Rokas Sforazatës për Kazalët e Shqipatërëve, ishte menduar së fundmi nga Dhoma Mbretërore për imunitet ndaj dhuratave, edhe pse një klauzolë e tillë nuk ishte në privilegj, dhe nuk ishte kaq i shtrirë si privilegj i këtij shteti (Isernia); dhe kur tha se dekreti në atë rast përmban një klauzolë, me kusht që shqiptarët të mos numëroheshin gjetiu, kjo gjë ishte sepse në priviliegj ishte një klauzolë e ngjashme me atë së cilës donte t'i referohej dekreti.)*

[136] *Histor. lib. 26. et lib. 29.*

[137] Lib. 29.

emrin Musacchio, prijës i vjetër dhe kalorës trim; siç flet edhe për 500 shqiptarët që ishin kalorës të huaj në shërbim të Venedikut; kapedan i tyre ishte Nicolo Masi, një njeri shumë trim, mbiemri i të cilit në gjuhën shqipe do të thotë 'mëz'[138]. Nën pushtetin e mëkëmbësve të mbretit, fati i shqiptarëve qe i lëkundshëm. Për aq sa vazhduan idetë e frymëzuara nga ata sovranë të urtë, ata gëzuan të gjithë mbrojtjen dhe u ruajtën të paprekura privilegjet e tyre; dhe autorët tanë e përmendin kujdesin e duhur të qeverisë për të pasur shqiptarë për të populluar shumë feude të pabanuara të shpërndara nëpër mbretëri[139]. Por, pasi këshilli[140] nuk ndoqi më gjurmët e politikës së vërtetë, nuk u panë më koloni të reja shqiptare; dhe ato koloni që ishin këtu, ranë në gjendje të keqe dhe në varfëri. Dekreti 24[141] *de Baron* i lëshuar në periudhën kur mëkëmbës i mbretit ishte Konti i Onnate-s dhe Villamediana-s për një përfaqësi të Dhomës Mbretërore[142] edhe pse i urtë dhe i drejtë për atë që ka të bëjë me ndërtimin e ri të territoreve dhe të fshatrave etj., edhe për pikën, për të cilën po flasin, me siguri nuk i bën shumë nder ministrisë së asaj kohe[143]. Më mirë dhe me më tepër korrektësi do të kishte mundur të

---

[138] *Galetarum vero equitum numerus, et pileatorum Epirotici generis levioris armaturae, qui erant peltati, quingentum summam implebat. His praeerat Nicolaus Masius è Nauplio Peloponnesiaco vir egregie fortis, cui* Polledro *Epirotica lingua cognomen fuit* – Juvius lib.
(Në fakt numri i helmetave të kalorësve dhe i kasketave të Epirotëve armatosur më lehtë, të pajisur me peltë (mburojë gjysmërrethore), arrinte në 500. Këtyre u printe Nikolaus Masius, nga Nauplio, burrë tepër i fuqishëm, i cili në gjuhën epirotase njihje me nofkën Polledro – libri i Juvit.)
19. Hist.

[139] *V. Thor. ad Salernitan. V. Thor. Saernites Dec. 40. n. 2.*, ku si një provë më tepër citon de Ponte, Rendella etj.

[140] 'Il Consiglio collaterale' ose 'il Collaterale': Këshilli i Lartë i Mbretërisë së Napolit i krijuar në vitin 1516 nga Ferdinandi. [Shënim i përkthyesit.]

[141] Shkurt: 'prammatica', ose 'prammatica sanzione': ligje ose dekrete mbretërore për çështje të ndryshme. [Shënim i përkthyesit.]

[142] 'Regia Camera della Sommaria', shih më sipër. [Shënim i përkthyesit.]

[143] Thotë midis të tjerash: "Përvoja na ka treguar se deri tani nuk ka dhënë ndonjë rezultat fakti që u është lejuar hyrja dhe u është krijuar mundësia që të vijnë e të banojnë aty banorët e kombeve të tjera; por duhej që këto gjëra t'i ndalonim me urdhëresa dhe me dekrete të veçanta".

shprehej dekreti në mënyrën se si është shpjeguar Markezi Palmieri në traktatin e tij *Ricchezza Nazionale* ("Pasuri kombëtare") *kap. 9*. "Edhe Shqipëria, por më vonë se sa Greqia, kur të dyja ishin në kohën e tyre të keqe, na ka dhënë koloni dhe, megjithatë, na i premton. Duket se shembulli i Chieuti-t dhe i fshatrave të tjera, çerdhe të turpshme kusarësh dhe kontrabandistësh, nuk do të duhej t'i bënte shumë të mirëpritura, nëse nuk do të kishte një numër më të madh fshatrash me shqiptarë që prodhojnë të ardhura dhe që kanë punëtorë të zellshëm; prandaj shembulli i paraqitur nuk mund të vlejë për karakterin kombëtar". Mbreti katolik që rivendosi të gjitha institucionet e paraardhësve të tij të ndritur, nuk la pa ua drejtuar vëmendjen veçanërisht shqiptarëve. Pra, jo vetëm që lejoi të ngrihej në Kalabri një kolegj për edukimin e të rinjve të atij kombi dhe krijimin e një ipeshkvie të ritit grek, por, për më tepër, autorizoi që të dy të pajiseshin me pasuritë e Abacisë Mbretërore të San Benedetto Ullano-s; dhe, përveç kësaj, për ta mbuluar kombin edhe më tepër me benefite, këto pasuri i liroi nga çdo lloj tatimi dhe takse[144]. Gjatë kësaj kohe që po bënte gjithë këto akte bujarie,

[144] *Entre las demas gracias, que ha suplicado el Rey Don Felix Samuel Rodotà Arzobispo, y Presidente del Collegio de los Statos Albanenses, que nuebamente se ha fundado por su Santidad en la provincia de Cosenza, para la buona educacion de los Jovenes Ecclesiasticos, y para la mas exacta observancia de la disciplina Ecclesiastica, una de dichas gracias ha sido la exempcion de las colectas, e imposiciones, que en dicurso de tiempo, con authoridad Apostolica, y Real se podrian imponer sobre los bienes Ecclesiasticos, y por consequencia tanto sobre los bienes del mismo Colegio, como sobre lo que han side senalados al nuebo Obisbo, y haviendo venido la Real Clemenza de Su-Magestad en concederle la exemcion de las Colettas, e imposiciones Reales por los Bienes, que presentemente estan asignados al Colegio, y a Su-Presidente, y si en ello hubiere perjuicio a alguna Universidad, o particular, vaya a adano de Su-Magestad, y este no deba en lo venidero tener mayor extencion. Lo prevengo a U. S. de Su Real Orden, paraque la Camara de la Sumaria entendida de su sobrana resolucion pueda disponer su debido complimiento. Dios guarde a U. S. muccios anos, como deseo. Palacio y Mayo 18. de 1736.* (*Një ndër nderet e tjera që ka kërkuar Mbreti Felix Samuel Rodotà Arqipeshkv dhe President i Kolegjit të Shteteve Shqiptare, i themeluar së fundmi nga Shenjtëria e Tij në provincën e Kozencës për miredukimin e të Rinjve Kishtarë si dhe për një respektim sa më rigoroz të disiplinës Kishtare, ka qenë edhe përjashtimi nga taksat dhe tatimet që me kalimin e kohës, me autoritet Apostolik dhe Mbretëror*

e hapi përsëri komunikimin me Shqipërinë, me Epirin dhe me Maqedoninë; themeloi Regjimentin Mbretëror Maqedonas, duke e shpallur kombëtar, siç e thamë më lart; dhe jo vetëm i dha strehë në Abruco një kolonie shqiptare të mbërritur kohët e fundit, por, për më tepër, e pasuroi duke i dhënë prona të shumta nga pronat e shtetit. Ferdinandi IV i derdhi benefitet e tij me kujdes në të mirë të shqiptarëve. Themeloi ipeshkvinë greke në Sicili, duke e pajisur me renta të mjaftueshme. Pranoi dhe priti një koloni tjetër në Brindizi, duke e mbrojtur, duke e inkurajuar dhe duke e pajisur me të gjitha gjërat e nevojshme, edhe pse pastaj kjo gjë nuk u përputh ne synimin e tij, siç e shpjeguam hollësisht me lart. Më së fundi shtoi në mënyrë të ndjeshme rentat e Kolegjit italo-grek të Kalabrisë.

Por, meqë po flasim sërish për këtë pajisje më së miri të kolegjit të sipërpërmendur, është e udhës që të vëmë në dukje diçka në mënyrë edhe më të saktë, meqë bëhet fjalë për një ngjarje shumë të rëndësishme për shqiptarët e Kalabrisë; kjo ngjarje i jep lavdi edhe atij që ka ndihmuar të japë frytet e çmuara.

Ipeshkvi i ritit grek, imzot Francesco Bugliari, një njeri i shquar për aftësitë, për dijen e tij dhe për pastërtinë e zakoneve, duke qenë i frymëzuar nga një zell i zjarrtë për të mirën publike, sapo u caktua drejtor i Kolegjit të mësipërm, përdori të gjitha forcat e tij për t'i dhënë shkëlqimin që meritonte dhe që të ishte i dobishëm për kulturën jo vetëm për shqiptarët, por për gjithë Kalabrinë.

---

mund t´u vendoseshin pasurive kishtare e për pasojë pasurive të vetë Kolegjit, si dhe pasurive që i ishin caktuar Peshkopit të ri. Me ardhjen e Faljes Mbretërore[1] , lëshuar nga Madhëria e Tij, përjashtoheshin nga taksat dhe tatimet Mbretërore pasuritë që aktualisht i ishin dhënë Kolegjit dhe Presidentit të tij dhe nëse ky përjashtim do t´i sillte dëm ndonjë bashkësie apo individi, dëmi do të kalonte në ngarkim të Madhërisë së Tij dhe ky përjashtim nuk do të shtrihej më tej në të ardhmen. Njoftoj Zotërinë Tuaj mbi Urdhërin Mbretëror me qëllim që Dhoma e Sumarias[2], pasi ka marrë dijeni për vendimin tuaj sovran, të mund të procedojë me zbatimin e tij. Zoti e ruajtë Zotërinë Tuaj për shumë vjet! Pallati, në maj 18 të vitit 1736.)

(1.Falje Mbretërore (Real Clemenza) - Dokument Mbretëror që Përjashtonte nga Taksat
2. Dhoma e Sumaria-s (Cámara de la Sumaria) – Gjykatë e Llogarive të Mbretërisë)
D. Joseph Joachim de Montealegre. Senor Don Luis Paternò.

Pra, në vitin 1792 iu lut mbretit për rritjen e rentave dhe për ndryshimin e ndërtesës, meqë San Benedetto Ullano, ku ndodhej Kolegji më parë, kishte një ajër të dëmshëm për shëndetin. Me këtë çështje u ngarkua don Giuseppe Zurlo, atëherë gjykatës në Gjykatën e Lartë[145] dhe pastaj Ministër i Financave; kultura e tij e lartë, pikëpamjet e tij me horizont të gjerë për të mirën e shtetit dhe zelli i tij i pafund për begatinë e mbretërisë, bënë të mundur që ai ta shihte me përparësi rëndësinë e mbrojtjes së kombit shqiptar dhe rritjen e nivelit kulturor të tij. Pra, pasi e shtjelloi çështjen, mbreti mori gjithçka në konsideratë; më tej, me një njoftim të datës 1 mars 1794 mori vendimin: "Madhëria e tij, që ka si qëllim gjithmonë shtimin e mjeteve të arsimit publik, qoftë për sa i përket anës së diturive shkencore, qoftë për sa i përket asaj të moralit publik, e ka parë se duhet marrë në konsideratë ajo çka i është paraqitur në lidhje me Kolegjin italo-grek. E ka vëzhguar me keqardhje gjendjen si është katandisur, duke pasur parasysh se si u krijua për edukimin e një pjese të rëndësishme të Kalabrisë katolike, dhe sidomos të klerit, që u mor në shqyrtim nga vetë Selia e Shenjtë. Detyrat e mbretit, madje vetë nevojat, e detyruan që të mos bënte sikur nuk e shikonte dëmin, që e ka marrë parasysh, dhe që të mos e linte pas dore një çështje kaq të rëndësishme, që ka lidhje me Kishën, mbrojtës i së cilës është çdo princ, si edhe shteti. Dhe pra, duke mos gjetur asnjë mjet tjetër për zgjidhje, dhe as një seli të përshtatshme ku të transferohej kolegji në fjalë, që ndryshe do të shkatërrohej, qoftë për ajrin jo të shëndetshëm, që ishte bërë kështu për arsye të fatkeqësive që dihen, qoftë për rentat e dobësuara dhe të bëra të pamjaftueshme për ta mbajtur; duke përdorur të drejtën e tij, dhe prandaj duke e ndërruar vullnetin e themeluesve, vendosi që nga San Benedetto Ullano të zhvendoset në Manastirin e Shën Adrianit, dhe që murgjit bazilianë, të cilët ndodhen tani aty, të shpërndahen në katër manastiret e tjera të të njëjtit urdhër në mbretëri, duke e përshtatur numrin, në më shumë

[145] 'Gran Corte della Vicaria' u krijua nga Karli II Anzhu dhe përbënte Gjykatën e Parë të Apelit për të gjitha gjykatat e Mbretërisë së Napolit. [Shënim i përkthyesit.]

ose në më pak, në përpjesëtim të kapacitetit të vetë manastireve; Zotëria Juaj i nderuar, së cilit Shkëlqesia e Tij ia beson zbatimin, të përpiqet që të vërë në ujdi të parët e kuvendeve përkatëse. Dhe që të mos lindin vështirësi, dhe as ankime nga këto manastire, në ngarkim të të cilave duhet të jenë murgjit, urdhëron që t'u caktohen për t'u dhënë atyre për mbajtjen e murgjve pesëdhjetë dukatë për secilin murg, që në të vërtetë ndodhet në Shën Adrian; derdhja e kësaj shifre duhet të zgjasë për sa kohë ata do të jenë në jetë; në vijim kjo shifër do t'i jepet sipas kohës kur secili murg do të ndërrojë jetë, kolegjit në fjalë, të cilit si rrjedhojë duhet t'i jepen rentat me këtë shumë; dhe duhet t'i dorëzohet, përpara inventarit të saktë e të qartë dhe dokumentit që pasqyron gjendjen e pronës, Drejtorit të vetë kolegjit, me detyrimin që t'i dërgojë një kopje legale Sekretarisë Mbretërore të Kishës; Madhëria e Tij ruan të drejtën që të shpjegojë vendimet e veta për feudet e bashkangjitura dhe për ushtrimin e juridiksionit. Dhe, meqë ka shumë mundësi që të jetë e udhës që të jepet një rregullore tjetër e brendshme e Manastirit në fjalë, mbreti më ngarkoi që të komunikoj urdhrin që i leverdis Drejtorit të vetë Kolegjit; rregullorja duhet zbatuar për përdorim dhe për nevojat e vetë Drejtorit, të konviktorëve, të mësuesve të tyre dhe të çdo personi tjetër që i nevojitet Kolegjit. Dhe duke qenë kaq shumë qëllimet e mbretit, Madhëria e Tij ka besim se murgjit bazilianë të Shën Adrianit dhe murgjit e tjerë të të gjithë urdhrit, të çuar nga instituti i tyre në një jetë më të përsosur dhe ungjillore, jo vetëm do të bashkëpunojnë plotësisht për të zbatuar vendimin e domosdoshëm që është marrë, por edhe do ta lavdërojnë. Ia transmetoj sipas urdhrit të mbretit zotërisë tuaj të nderuar për zbatim." Pallat. 1 shkurt 1794. Ferdinando Corradini. Pas kësaj epoke lulëzoi Kolegji në letërsi dhe degët dhe parimet që kanë të bëjnë me edukimin; dhe një përzgjedhje mësuesish tepër të përgatitur e ndihmoi më shumë shkëlqimin e Kolegjit dhe për lavdinë e atij vendi. Unë nuk do ta bëja detyrën time, në qoftë se këtu nuk do të përmendja stolinë më të ndritur të kolegjit, priftin dom Michele Belluscio, filozof i shquar dhe orator i shkëlqyer,

për humbjen e parakohshme të të cilit kombit shqiptar do t'i vijë gjithmonë shumë keq.

Për këto arsye, jo vetëm shqiptarët, por edhe italianët u përpoqën kush e kush t'ia kalonte tjetrit për të dërguar fëmijët e tyre në atë Kolegj. Por në vitin 1799, fatkeqësisht, u plaçkit nga disa keqbërës; por Imzot Bugliari-n nuk e lëshoi zemra dhe pas pak kohe me të hollat e veta e rivuri gjithçka në gjendjen e mëparshme.

Por, fati i keq i Shqiptarëve e asgjësoi sërish atë vend: banditët e Kalabrisë në vitin 1806 e plaçkitën sërish: dhe ipeshkëv Bugliari i dërrmuar nga dhimbja, në vend që të largohej, vendosi që të mbetej viktimë e atij tërbimi të marrë të atyre maskarenjve. Ky njeri i rrallë u vajtua nga të gjithë me të drejtë; dhe këshilltari i Napolit, në numrin 54 të datës 2 shtator 1806, i bëri lavdërimin e duhur.

PËRFUNDIM

Tani, nëse në kohë të vështira kombi shqiptar pati shumë akte bujare nga qeveria e Napolit, me sa shumë të drejtë shpreson që sot të jetë i mbrojtur nga kjo qeveri? Sot që kultura e shekullit e ka rralluar errësirën e politikës së rreme, e cila i ka bërë shumë dëme atij populli; sot që është kuptuar rëndësia e shtimit të numrit të popullsisë në çdo mbretëri, dhe sidomos në këtë këtu; sot që dihet që shqiptarët, Pirrot, Skënderbejtë janë bërë të shquar jo për ndonjë gjë tjetër, por për bëmat heroike të kombit trim shqiptar; sot kur një qeveri e madhe nuk ka synim tjetër, përveçse të ndihmojë nevojtarët, ata që meritojnë, që t'u japë jetë shpirtrave të shtypur; sot më së fundi që vetë qeveria kujdeset për edukimin publik dhe për shqiptarët, gjysma e punës është e mbaruar, meqë Kolegji italo-grek (mjafton që të mbrohet) pa dyshim premton gjëra të mëdha, sidomos nën vëzhgimin e drejtorit të shkëlqyer të tanishëm, imzot dom Domenico Belluscio; sot, them, plot besim llogarisin shqiptarët që të nxjerrin përfitimet më të mëdha, përfitime, që ndërsa do të jenë të leverdishme për ta, do të jenë po ashtu të lavdishme për mbretin, dhe frytdhënës për shpërblime të pafund për shtetin.

PASTHËNIE

Alfred de Vinji e përkufizonte shkencën si "elikzirin hyjnor që pinë shqiptarët". Ky përkufizim ka aromën e idealizmit romantik, po është edhe një sintezë e thelbit të dijes, e rëndësisë së saj për njeriun. Shekulli XIX ka qenë në fakt shekulli i shkencës, në veçanti koha kur shkencat e ndryshme shoqërore, historia, antropologjia, etnografia, folkloristika, historia e letërsisë lulëzuan gjerësisht. Edhe kultura arbëreshe në zhvillim e sipër do të pasurohej me ese, studime dhe vepra më të gjera që u përkasin këtyre disiplinave. Një prej tyre qe fjalimi i stuiuesit dhe këshilltarit të shtetit, arbëreshit të shquar Angelo Masci (Anxhelo Mashi) "Mbi origjinën, zakonet dhe gjendjen e tanishme të shqiptarëve të Mbretërisë së Napolit", kushtuar bashkësisë arbëreshe të transplantuar në Itali dhe, në plan të gjerë, kombit shqiptar, shumë pak të njohur, që u botua në Napoli në vitin 1807, dyzet vjet para veprës së ngjashme me atë të Vinçenc Dorsës "Mbi shqiptarët: gjurmime dhe mendime". Ky shkrim ndërdisiplinor do të përkthehej në frëngjisht nga dijetari i shquar Maltobrun dhe do të botohej i plotë në gazetat më të mira franceze.

Përkthimi i kësaj vepre në frëngjisht në një kohë kur kjo gjuhë kishte një përhapje veçanërisht të gjerë në shkallë europiane jo vetëm që i hapte autorit dyert e famës, po i nxirrte në dritë vlerat e panjohura të një kombi të lashtë dhe trim.

Angelo Masci spikaste si për erudicionin ashtu edhe për talent. Vepra e tij s'ishte vetëm e një dijetari që synonte të ishte objektiv, po e një patrioti të përkushtuar që po ndërgjegjësohej për vetitë

e kombit të vet dhe donte t'i shpallte para publikut italian dhe, mundësisht, europian.

Në këtë shkrim ndërthuren historia, gjuhësia dhe antropologjia. Në radhë të parë aty mbrohen me argumenta solide dhe të pakundërshtueshme origjina e lashtë e popullit shqiptar, mendjet e tij. Mandej nxirren në dritë tiparet më fisnike të këtij kombi si trimëria dhe shpirti liridashës.

Në shkrimin e tij Angelo Masci ndjek hap pas hapi rrugëtimin historik të arbëreshëve në Itali dhe nënvizon padrejtësitë që iu kanë bërë atyre nga feudalët dhe kisha dhe që kanë penguar zhvillimin e tyre kulturor dhe gjithashtu evidenton personalitete arbëreshe si M. Bellusci dhe imzot Buglieri që sintetizon potencialin kulturor të arbëreshëve.

Për të mbështetur tezën e tij të lashtësisë së popullit shqiptar, përveç argumenteve historike, Masci përdor edhe argumente gjuhësore, duke e ilustruar këtë tezë me fjalë shqip.

Fjalimi i Masci-t dallohet si për patosoratorik, koherencë dhe forcë logjike ashtu edhe për konçizitet dhe saktësi.

Ky shkrim do t'ua çelë rrugën në shekullin e vet shkrimeve diturore të Dorsës, De Radës, Kamardës.

Botimi i tij në gjuhën shqipe është një arritje e ndjeshme dhe plotësimi i një borxhi ndaj autorit të tij.

Vlerat e këtij shkrimi tingëllojnë tepër aktuale në një kohë kur rrezikohen vlerat tradicionale të atdhedashurisë, krenarisë, frymës liridashëse së kombit shqiptar. Pikërisht këto vlera himnizohen në fjalimin e këtij arbëreshi fisnik.

KLARA KODRA

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë
Fjalim i këshilltarit të shtetit Angelo Masci : mbi origjinën, zakonet dhe gjendjen e tanishme të shqiptarëve të Mbretërisë së Napolit / nën kujdesin e Francesco Masci ; përkth. Edmond Çali ; red. shkenc. Klara Kodra. - Tiranë : Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, 2021
92 f. ; 16x24 cm.
Tit. orig.: Discorso del consigliere di stato Angelo Masci sull› origine, i costumi e lo stato attuale degli albanesi del Regno di Napoli
ISBN 978-9928-4664-9-5
1.Historia 2.Arbëreshë 3.Studime sociale 4.Itali

94(=18:450)
908(=18:450)